

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Studime pasdiplomike – Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim



Punim diplome

Tema: Menaxhimi i mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit

Mentori:

Prof. Dr. Arafat Shabani

Studenti:

Shkelqim Kozhani

Tetovë, 2020

PËRMBAJTJA

Contents

PËRMBAJTJA.....	2
Lista e tabelave	4
Falënderime.....	6
Abtrakti	7
Hyrje	8
KAPITULLI I	11
1.1.Rishikim I literaturës.....	11
1.2 E-mësimi në Republikën e Kosovës	14
1.3. Sfidat kryesore te mësimi online.....	17
1.4.Sa janë të përgatitur mësimdhënësit për zbatimin e platformës së mësimi online?.....	18
KAPITULLI II	21
2.1.Menaxhimi i mësimi në distancë gjatë pandemisë Covid-19	21
2.2. Mbyllja e shkollave dhe organizimi i mësimi online (online) në Republikën e Kosovës.....	22
2.3. Organizimi i mësimi online nga mësimdhënësit e komunës së Lipjanit.....	23
2.3.Paisjet dhe platformat teknologjike të zhvillimit të mësimi online.....	26
2.4.Vlerësimi i mësimdhënësvë për mësimin online ose online, sfidat dhe mundësitë	28
2.5. Epërsitë dhe mangësitë e menaxhimit të mësimi në distancë	32
KAPITULLI III.....	35
3.1.Metodologjia e punimit.....	35
3.2.Lënda e hulumtimit	35
3.3.Qëllimi I hulumtimit	35
3.4. Hipotezat kryesore të këtij punimi janë;	36
3.4.1.Hipoteza gjenerale.....	36
3.4.3.Hipoteza e veçantë	36
3.5.Metodologjia e hulumtimit.....	37
3.5.1 Metodot dhe teknikat e hulumtimit	37
3.6.Instrumentet e mbledhjes së të dhënave.....	37
3.7.Popullacioni dhe mostra.....	38
3.8.Rëndësia e punimit.....	39
KAPITULLI I IV	40
4.1 Analiza dhe interpretimi i rezultateve	40
4.2 Rezultatet nga pyetësi me mësimdhënësi	40
Tab. Nr.8. Niveli arsimor – Fakulteti i Pedagogjisë.	47

4.4 Rezultatet nga pyetësi me drejtorët e shkollave.....	63
Të dhënat personale për mësuesin.....	63
Të dhënat personale për drejtorë	Error! Bookmark not defined.
4.5 Rezultatet e përgjithshme të intervistës me prindër	91
KAPITULLI V	96
5.1.Përfundime dhe rekomandime	96
5.2. Rekomandime	98
BIBLIOGRAFIA	99
Shtojca	105
Të dhënat personale për mësuesin	105
Të dhënat personale për drejtorë	108
Pyetjet që u janë adresuar prindërve në formë bisede.....	112

Lista e tabelave

Tab. Nr.1. - Statistics (Statistikat përmbledhëse).....	28
Tab. Nr.2. Gjinia: meshkuj – femra.....	29
Tab. Nr.3. moshë 21-40 Gjinia: meshkuj – femra.....	30
Tab. Nr.4. Moshë e mësimdhënësve: meshkuj - femra (41 – 55 vjeç).....	31
Tab. Nr.5. Moshë: mbi 55 vjeç (meshkuj- femra).....	32
Tab. Nr.6. Niveli arsimor: Master.....	33
Tab.Nr.7. Niveli arsimor: Fakulteti i Edukimit (Bachelor).....	34
Tab. Nr.8. Niveli arsimor – Fakulteti i Pedagogjisë.....	35
Tab. nr.9. Statistika deskriptive (Përshkruese).....	36
Tab.nr.10 1. Si e njihni nocionin mësim online ?.....	37
Tab.11.2. Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?.....	38
Tab.nr.12.3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të paisjeve teknologjike.....	39
Tab.13.4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?.....	40
Tab.14.5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?.....	41
Tab.nr15.6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?.....	42
Tab.16.8. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?.....	43
Tab.17.9. Eksperiencat e juaja për përparësitë e mësimin online?.....	44
Tab.18.10. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online.....	45
Tab.nr.19.Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimin online?	46
Tab.nr.20.11. Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin online?.....	47
Tab.nr.21.12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nëse po, në cilat aspekte?.....	48
Tab.nr.22.13. Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?.....	49
Tab.nr.23.14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?.....	50
Tab. Nr.24.- Statistics (Statistikat – moshë dhe niveli arsimor i drejtorëve të shkollave).....	51

Tab.nr.25. Drejtorët –Mosha: 21- 40 vjeç.....	52
Tab.26. Drejtorët –Mosha: 41 – 55 vjeç.....	53
Tab.27. Drejtorët mbi 55 vjeç.....	54
Tab.nr. 28. MASTER.....	55
Tab.nr.28. BACHELOR.....	56
Tab.nr.29. Fakultet tjetër.....	57
Tabela nr.30. Statistika deskriptive (Përshkruese për drejtorë).....	58
Tab.nr.31 1. Si e njihni nocionin mësim online ?.....	59
Tab.nr.32.2. Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?.....	60
Tab.nr.33.3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike.....	61
Tab.34.4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?.....	62
Tab.35.5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi.....	63
Tab.nr.36.6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?.....	64
Tab.nr.37. 7. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?.....	65
Tab.nr.38. 8. Eksperienat e juaja për përparësitë e mësimin online?.....	66
Tab.nr.39. 9. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online?.....	67
Tab.nr.40. 10.Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimin online?.....	68
Tab.nr.41.11.Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin nga distanca.?.....	69?
Tab.nr.42.12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nëse po, në cilat aspekte?.....	70
Tab.nr.43.13 Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?71	
Tab.nr.44.14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?.....	72

Falënderime

Natyrishisht se rrugëtimi im i deritanishëm dhe avancimi në karrierën time profesionale, nuk do të ishte ky që është pa ndihmën, kontributin dhe mbështetjen e profesorëve, kolegëve, miqve e në veçanti familjes sime. Falënderim i veçantë i dedikohet mentorit tim Prof. dr. Arafat Shabani për mbështetjen e çmuar drejt finalizimit të këtij punimi të diplomës. Falënderoj poashtu, të gjithë miqtë e kolegët e fakultetit për këshillat dhe prezencën e tyre përgjatë këtyre dy viteve studime. Së fundmi, dëshiroj t'i shpreh falënderimet më të përzemërta familjes sime të cilës i detyrohem jashtëzakonisht shumë. Inkurajimi dhe përkrahja e tyre ishin shtytja dhe inspirimi kryesor që ta përmbyll me sukses këtë udhëtim. Ju falënderoj të gjithëve!

Abtrakti

Menaxhimi i mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësime dhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit ishte një sfidë e madhe. Kjo dukuri aq sa ishte e papritur dhe me shumë të panjohura në shkollat në Republikën e Kosovës dhe në komunën e Lipjanit, i gjeti të papërgatitur të gjithë faktorët themelorë të shkollës për të realizuar një mësime të tillë siç ishte mësime online. Ky punim jep përgjigje rreth asaj se si u menaxhua mësime online nga mësime dhënësit e komunës së Lipjanit me rrethinë, përqendrimi në platformat online, si dhe pajisjet teknologjike që u përdorën në shkolla.

Në këtë hulumtim, shtjellohet hollësisht prezantimi ose shtjellimi i literaturës, gjithnjë duke e vendosur në funksion të analizës dhe hulumtimit, zhvillimit dhe menaxhimit të mësimit online nga mësime dhënësit e komunës së Lipjanit me rrethinë, sidomos në procesin e mësime nxënies, në raste kur është e rëndësishme të mbrohet shëndeti i nxënësve dhe i të gjithë protagonistëve të shkollës. Të dhënat e grumbulluara tregojnë për shqetësimet e nxënësve, prindërve dhe mësime dhënësit, të ndërlidhura me rrethanat e shkaktuara për shkak të izolimit social gjatë kohës së pandemisë së shkaktuar nga virusi korona ose 'Covid 19'. Poashtu, ky punim bën fjalë edhe për perspektivën e mësime dhënësit dhe të prindërve rreth mësimit online. Gjetjet e konfirmojnë gatishmërinë dhe motivimin e mësime dhënësit për t'u pajisur me njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për të kontribuar në avancimin e cilësisë së mësimit. Mundësitë për të avancuar cilësinë e mësimit online, mbështetja e mësime dhënësit, prindërve dhe familjeve, është shoqëruar me sugjerime praktike për palët e involvuara në fushën e arsimit.

Fjalët kyçe: Covid-19, mësime online, nxënësit, prindërit, mësime dhënësit, sfidat, mundësitë

Hyrje

Duke u bazuar në titullin e punimit “**Menaxhimi i mësimin online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit**” do të mundohemi të kuptojmë se si u menaxhua mësimi online nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit, cilat ishin përparësitë dhe vështirësitë që hasën institucionet shkollore në gjendje pandemie për ta zhvilluar mësimin online, për ta mbrojtur humbjen e vitit shkollor. Gjithashtu qëllimi ynë ka qenë që të vëmë në fokus dhe të paraqesim revolucione të cilat ndodhin në botën moderne, e të cilat do ta ndihmonin jetësimin e mësimin online edhe në suazat e normalitetit, duke marrë për bazë që bashkë me arritjet teknologjike të ndryshojmë edhe ne si individ.

Për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu si edhe në shumë vende të botës, urdhëroi mbylljen e shkollave nga 12 marsi, fillimisht me afat të kufizuar dhe më pas mbylljen pa afat të tyre. Vendimi i MASHT doli me konfirmim, që i gjithë sistemi të kalonte *online*, nga 23 marsi, por ende dhe sot mungojnë specifikimet e platformave digjitale gjithëpërfshirëse që të mund të garantojnë mësimdhënie cilësore në këtë situatë. Mbajtja në konsideratë e nevojave specifike të mësuesve dhe të nxënësve lidhur me aksesin në internet dhe pajisjet teknologjike në dispozicion ishte domosdoshmëri. Pavarësisht sfidave, të gjitha institucionet arsimore publike e private në bashkëpunim edhe me aktorët politikë dhe donatorët kanë reaguar shpejt për të përballuar këtë situatë. Bazuar në përparësitë e mësimin online dhe nevojat e sistemit arsimor në shkollat tona, aplikimi i mësimin online, u bë domosdoshmëri për shkak të gjendjes së krijuar të pandemisë. Në fakt, mësimi online në Republikën e Kosovës në kushtet e pandemisë, si edhe në shumicën e vendeve të rajonit, filloi pa përgatitjet e duhura që do të duhej ta shoqëronin një sipërmarrje të tillë. Prandaj edhe duhet pranuar se mësimi online në Republikën e Kosovës ballafaqohet me të panjohura, të cilat duhet të adresohen me kohë dhe duke ju përshtatur kontekstit. Në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë globale COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore, në datën 12 mars 2020 për një periudhë dy javore. Ky vendim u rinovua në datën 23 mars dhe aktualisht sistemi arsimor në Republikën Kosovës për shkak të nivelit të lartë të karantimit dhe distancimit social të detyruar, do të mbetet mbyllur deri në përfundim të situatës së pandemisë apo vendimit të qeverisë për të rihapur sistemin arsimor në vend. Kjo situatë e izolimit të menjëhershëm në mjedise shtëpie ka dëmtuar, në radhë të parë, përfituesit kryesorë të sistemit arsimor, nxënësit

dhe studentët, por njëkohësisht ka sfiduar edhe drejtuesit e kësaj fushe në Republikën e Kosovës dhe trupat pedagogjike e drejtuese në arsim. Në këto rrethana ka marrë rol të rëndësishëm parësor krijimi i eko-sistemeve virtuale që mundësojnë mësimin online – strategjia e propozuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si përgjigje për të kapërcyer pengesën e ndjekjes fizike të studimeve nëpër institucione arsimore për shkak të karantinës. Prandaj, përdorimi i teknologjisë për t'i mbajtur funksionale sistemet arsimore në vende të ndryshme të botës, për shkak të izolimit të popullatës, u konsiderua si alternativa më përshtatshme dhe e vetme në këtë periudhë. Përhapja e Covid-19 gjithashtu ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësime të tjera te qytetarët në vende të ndryshme të botës (NCIRD, 2020). Sidoqoftë, niveli i shqetësimeve përgjatë të njëjtës periudhë supozohet të jetë ndikuar edhe nga faktorë të tjerë, në kuadër të grupeve të caktuara të qytetarëve të involvuar në edukim. Sipas UNESCO “shqetësimet e prindërve, përveç nga rrethanat e krijuara për shkak të izolimit social dhe faktorëve të tjerë personalë, supozohen të jenë ndikuar nga mospërgatitja e prindërve për të mbështetur fëmijët e tyre me mësimin online ose mësimin nga shtëpia, mungesën e qasjes në teknologji, dhe në internet ose papërshtatshmërinë e formave teknologjike të përdorura për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, dhe vështirësitë ekonomike” (UNESCO, 2020).

Shqetësimet e mësimdhënësve të komunës së Lipjanit të angazhuar në proceset mësimore është vërejtur të jenë ndërlidhur me mundësitë për të realizuar mësimin online për shkak të nivelit të njohurive dhe shkathtësive të tyre për përdorimin e teknologjisë, qasjen në teknologji, dhe izolimin në shtëpi. “Shqetësime të tilla janë raportuar në veçanti nga shtetet në të cilat, para rrethanave të krijuara nga masat parandaluese kundër përhapjes së Covid-19, niveli i përdorimit të teknologjisë në klasë nga mësimdhënësit është deklaruar tejet i ulët (UNESCO, 2020). Po ashtu, kërkesat për të zhvendosur mësimin në formatin online, është raportuar të kenë ndikuar gjithashtu në rritjen e nivelit të stresit dhe ankthit të mësimdhënësve në pjesë të ndryshme të botës, ashtu sikundër edhe te mësimdhënësit e komunës së Lipjanit përmes të cilave janë matur faktorët personalë, psikologjikë dhe organizativë me ndikim në pjesëmarrjen e suksesshme të mësimdhënësve në ndryshim. Në këtë rast në realizimin e mësimin online, edhe te mësimdhënësit e kësaj komune, kërkesa për ndryshim vërehet të jetë e shoqëruar me një sërë faktorësh personalë, psikologjikë dhe organizativë. Kërkesa për ndryshim – e ndikuar nga mungesa e përvojës në mësimin online, niveli jo i mjaftueshëm i shkathtësive dhe njohurive për përdorimin e teknologjisë, të shoqëruara me mungesën e udhëzimeve të qarta për të vënë në funksion mësimin online dhe me mungesën e bashkëpunimit – është vërtetuar t’i ketë sjellë atyre parehati, mbingarkesë dhe pasiguri, faktorë këta, të cilët po ashtu supozohet se mund të ndikojnë më tutje, duke rritur nivelin

e stresit të mësimdhënësve, t'i bëjnë të ndjehen të lodhur ose të rraskapitur psikikisht, dhe t'u ndikojnë në rritjen e nivelit të rezistencës ndaj ndryshimit, performancën e tyre dhe nivelin e satisfaksionit me punën.

Pikërisht për t'i parë të gjitha sfidat, mundësitë, përparësitë, mangësitë e menaxhimit, mbarëvajtjes së procesit mësimor online nga mësimdhënësit e komunës në fjalë dhe për të përmbushur realizimin e matjes së këtij hulumtimi, ne kemi përzgjedhur mësimdhënësit, drejtorët dhe prindërit e shkollave të mesme të ulëta, sepse përmes tyre do ta kuptojmë gjendjen reale të shkollave tona, respektivisht se si është menaxhuar mësimi online nga mësimdhënësit në bashkëpunim me familjen, komunitetin dhe udhëheqësin e shkollës. Hulumtimit i janë nënshtruar 80 mësimdhënës, 80 prindër, dhe 8 drejtorë shkollave të ndryshme në rajonin e Lipjanit me rrethinë. Korpusi hulumtues përmban pyetje, të cilat u janë ofruar mësimdhënësve, drejtorëve dhe prindërve për matje në formë ankete. Më pas të dhënat e përfuara do të klasifikohen e përpunohen për të arritur në analizën, interpretimin e të dhënave. Mbi këtë interpretim do të paraqiten edhe përfundimet e arritura.

Nga ana strukturore punimi përbëhet nga katër krerë, në të cilët do të shtjellohen çështjet e ngritura më sipër.

◊ Kreu i parë pasqyron shqyrtimin e literaturës.

Kreu i dytë pasqyron menaxhimin e institucioneve arsimore të komunës së Lipjanit gjatë pandemisë, pajisjet dhe platformat digjitale të përdorura gjatë mësimin online, përparësitë dhe mangësitë e këtij lloj mësimi dhe sfidat, mundësitë që patën mësimdhënësit e kësaj komune për ta realizuar me sukses mësimin online gjatë pandemisë.

Kreu i tretë pasqyron metodologjinë e hulumtimit

Kreu i katërt ofron rezultatet e përgjithshme të hulumtimit;

Më pas punimi do të vazhdojë me pjesën shtojcë, ku do të paraqitet forma e pyetësorit për mësimdhënës, drejtorë e prindër, dhe përfundimet, në të cilat do të përmbledhim kryesisht rezultatet e përfuara gjatë hulumtimit dhe ilustrimit argumentues. Vlerat e përfuara do të paraqiten në mënyrë tabelore, si dhe me anë të grafikëve të ndryshëm për çdo pyetje të analizuar nga korpusi i zgjedhur hulumtues. Përfundimet, rekomandimet, pasqyrimi bibliografik, burimet e materialit të vjelë, do të shënojnë edhe fundin e këtij punimi diplome.

KAPITULLI I

1.1.Rishikim i literaturës

“Të mësuarit online mund të llogaritet si komunikim ndërmjet njerëzve në kohë dhe vende të ndryshme” (Collins, J., Hammod. M. & Wellington, J., 1997). Mësimi në distancë mund të definohet në mënyra të ndryshme, por “kryesisht ka të bëjë me përdorimin e teknologjive për të krijuar, shpërndarë dhe dhënë të dhëna, informata, mësim dhe dituri, për të përmirësuar performancën në punë, në organizatë, dhe për të siguruar zhvillimin personal (Brandon, 2008), ndërsa mësimi online ka të bëjë me ndërlidhjen e elektronikës ose teknologjive informative dhe të komunikimit me procesin arsimor. (Brandon, 2008). Mësimi online është përdorimi i teknologjive informative për të krijuar përvoja mësimore për të ndihmuar mësimin dhe nxënien (Henderson, 2009). “Edukimi në distancë (distance learning, e-Learning) është mënyra e re e studimit, e mundësuar nga teknologjia e informimit dhe komunikimit, është mësimi i së nesërme” (Tedesco, P.,& Falcioni, M., 2007), “Edukimi në distancë - të mësuarit online, mund të shfrytëzohet në mënyrë efektive për dhënien e njohurive, për individët të ndodhur në çdo vend, me kurset e pafundme që ofron” (Trivelli, 2006).

Mënyra e të nxënies online daton që nga koha e fillimit të komunikimit ndërmjet njerëzve. Ata filluan t’i bartin njohuritë e tyre brez pas brezi, madje edhe me fillimin e lëvizjes së tyre nga një vend në vendin tjetër, ku takonin popuj të tjerë me kultura dhe tradita të tjera. Pa dyshim se komunikimi i atyre kohërave ishte i vështirë, i ngadalshëm dhe jo i saktë. Shumë herë ngjante që informata gjatë kohës dhe vendit ku shpërndahej të pësonte ndryshime thelbësore, duke shkaktuar shtrembërimin e plotë të saj, madje duke dalë krejt diçka tjetër. Arsye e këtyre ndryshimeve gjatë transmetimit ishte se informatat barteshin në formë fjalësh të folura. Shfaqja e shkrim-leximit, bartja e letrave nëpërmjet postës, shpikja e radiotelevizioneve, shfaqja e shtypit, si dhe teatri, e pa dyshim edhe shkollat, ishin një kthesë e madhe në transmetimin e dijes nga autori deri te studiuesi, përkatësisht nga mësimdhënësi deri te nxënësi.

Ndërsa vitet dhe shekujt po kalonin, lehtësira në të nxënies online u krijuan nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, nëpërmjet internetit informatat barten në mënyrë të menjëhershme.” Kjo shpikje ndihmoi shumë edhe në zhvillimin e bartjes së dyanshme të informatave. Sot funksionojnë universitete dhe kolegje të ndryshme gjithandej shteteve të zhvilluara, të cilat e realizojnë të mësuarit online, e-learning. Ato, madje e kanë të rregulluar edhe çështjen e njohjes së plotë të diplomave, të cilat lëshohen me rastin e përfundimit të shkollimit përkatës” (Anderson, T.,&

Dron, J., 2010). Republika e Kosovës nuk mund të renditet në listën e atyre shteteve që janë duke e implementuar të nxëniet me mësimdhënie online që mbështetet në e-mësim (e-learning), m-mësim (m-learning), apo të atyre që kanë shkolla virtuale.

“Mësimi online e ka origjinën e tij në mesin e shekullit XIX në Evropë dhe në SHBA. Ideatorët dhe zbatuesit e parë të mësimin online përdorën teknologjinë më të mirë të kohës së tyre, sistemin postar, për të krijuar mundësi për njerëzit që dëshironin të mësonin, por nuk kishin kushte për të ndjekur shkollat tradicionale” (Mexhuani, Kërkime pedagogjike, 2011). Shumica e njerëzve që përfituan nga një mësim i tillë me korrespondencë përfshinte ata me pamundësi fizike, gratë të cilat nuk lejoheshin të regjistroheshin në institucionet e edukimit, të hapura vetëm për burrat, njerëzit që kishin punë gjatë kohës normale të shkollës dhe ata që jetonin në rajone të largëta ku nuk kishte shkolla.” Zhvillimi i madh teknik dhe shtrirja e gjerë e dy fushave themelore të elektronikës, radios dhe televizionit, në vitet 1920-1940 shënojnë dy ngjarje të rëndësishme në jetën e njerëzimit. Ato, duke i shërbyer shpërndarjes së informacionit dhe pasqyrit të jetës së përditshme, u bënë edhe forma të reja shumë të rëndësishme për përdorim në mësimin online” (Mexhuani, Kërkime pedagogjike, 2011). Mësuesit i përdorën këto teknologji të reja për t’iu shpërndarë programet edukative miliona të interesuarve, duke shtuar mundësitë e të mësuarit online përkundër pengesave të institucioneve tradicionale shkollore (Mexhuani, Kërkime pedagogjike, 2011). Zhvillimi i sistemeve telefonike të besueshme në largësi të mëdha gjatë viteve të para të shekullit XX, gjithashtu, shtuan mundësitë e mësuesve online për të rritur numrin e studentëve. Por, sistemet telefonike kurrë nuk luajtën një rol të rëndësishëm, derisa në vitet 1980-1990 u fut në përdorim teknologjia e telekonferencës. Sistemet e telekonferencës e bënë të mundur që mësuesit të bisedonin, të dëgjonin dhe shihnin studentët e tyre në kohë reale, pavarësisht ku ndodheshin.” Mësimi online përdor ndërthurjen e teknologjive të ndryshme të komunikimit për të rritur aftësitë e mësuesve dhe studentëve për të komunikuar me njëri-tjetrin” (Clark, R. D.& Majer, R. E., 2033). Vitet 1980 dhe 1990 shënojnë një tjetër arritje të njerëzimit atë futjes në përdorim masivisht të rrjeteve kompjuterike dhe të aplikimeve të internetit. Interneti ofroi shërbime të shumta dhe të paimagjinueshme. Kjo u krijoi mundësi një numri të madh mësuesish dhe studentësh të komunikonin në konferencë nëpërmjet kompjuterëve. Nëpërmjet përdorimit të konferencave me kompjuter në rrjetin e gjerë botëror mësuesit dhe studentët kishin mundësi të paraqitnin tekste, fotografi, zërin dhe pamjet e lëvizshme (video). Nëpërmjet video telekonferencave u bë e mundur që mësuesit dhe studentët të shihnin dhe të dëgjonin njëri-tjetrin, duke qenë të vendosur në vende të ndryshme.

Walden University, (2016) e themelon Open University në vitin 1970, i cili akreditohet për studime të plota online në shëndetësi, arsim, menaxhim, psikologji etj. Ky universitet në Shtetet e

Bashkuara njihet si lider global i studimeve online, i cili e vazhdon punën e tij edhe sot me studime online në shumë fusha studimi.” Gjenerata e tretë e mësimit online, e cila përfshin periudhën nga vitet 1985-1995, përdori teknologjitë e kompjuterëve dhe rrjeteve kompjuterike. Aktualisht jemi në gjeneratën e katërt të mësuarit online, që fillon nga viti 1995, kur përdoren kombinime të ndryshme të pajisjeve dhe sistemeve të kaluara të mësuarit online, ndikuar nga zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja të informatikës dhe kompjuteristikës” (Taylor, 2001). Tani studimet online zhvillohen në kohë reale nëpërmjet E-mësimit dhe M-mësimit (e-learning & m-learning), nëpërmjet videokonferencave, korrespondencës së dyanshme në kohë reale në mënyrë audio-vizuale. Korrespondenca mbahet në relacionet: student-mësimdhënës, student-student etj. Prandaj, siç mund të gjejmë edhe më gjerësisht nëpër historinë e zhvillimit të nxënimit online, konkludojmë se ky lloj i mësuarit është mjaft kompleks. Zhvillimi i tij është i mundimshëm dhe zgjat shumë. Për shkak të faktorit më të rëndësishëm të mësuarit, motivimit, shpesh ka ndodhur që pjesëmarrësit e këtyre studimeve ta humbin durimin, dhe si rrjedhojë ka qenë braktisja e shkollave të tilla. Por, ka edhe të tilla që megjithatë e kanë ruajtur motivin duke shkuar deri në fund, për çka edhe janë shpërblyer me vende pune, ngritje pagash, ruajtje apo ndërrim të vendeve të punës, kalim në grada më të larta etj. Sipas Brown “Efektet e përdorimit të teknologjisë në institucionet edukativo-arsimore janë hulumtuar edhe shumë vite më parë nga studiues të fushës së edukimit, përmes të cilëve është vërtetuar dhe promovuar se teknologjia mund të asistojë në procese të ndryshme arsimor” (Brown H. , 2012), (Hung, H. & Yuen, S. C, 2010) “të ketë ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënimit tek nxënësit” (Dyson, B., Vickers, K., Turtle, J., Cowan, S., & Tassone, A. , 2015), “të asistojë mësimdhënësit, dhe të ndihmojë ata në avancimin dhe zhvillimin profesional” (Manca, S. & Raineri, M., 2017); (Donelan, 2016)). “Prandaj, integrimi i teknologjisë në klasë është promovuar dhe mbështetur tani e shumë vite në vende të ndryshme të botës (Cope, C. & Ward, P., 2002)”. “Me zhvillimet e teknologjisë informative dhe të komunikimit dhe përdorimin e tyre në proceset mësimore, përveç se ofrohen mundësi më të mëdha për t’u realizuar mësimi fleksibil, njëkohësisht mësimi bëhet më i hapur, përmes të cilit synohet që nxënësit të jenë më të pavarur dhe të vetëpërcaktuar, përgjegjës për të nxënimit (Goode, 2007) dhe të fitojnë shkathtësitë vetërregulluese në raport me vendosjen e qëllimeve, të jenë vetëmonitorues dhe të përshtaten”. “Ndërsa, po e njëjta mundësi, mësimdhënësve u mundëson që të promovojnë të nxënimit aktiv në mënyrë që të nxënimit të jetë angazhues dhe efektiv” (Collis, 1998), “duke i bërë mësimdhënësit më tepër facilitues të procesit mësimor” (Huang, R.H., Liu, D.J., Tlili, A., Yang, J.F., Wang, H.H., , 2020) “duke i larguar ata nga përgjegjësitë për të realizuar mësimdhënien si të vetëm, dhe gjithashtu duke u dhënë nxënësve përgjegjësi” (Goode, 2007).” Për më shumë, qasja me nxënësin në qendër, me zhvillimin e teknologjisë, konsiderohet

komponenti kryesor i mësimi fleksibil, meqë i fuqizon nxënësit dhe mësimdhënësit që të ndajnë informacione me njëri-tjetrin në mënyrë të dyanshme” (Lundin, 1999). Mësimi online hap mundësi edukative, duke i lejuar nxënësit/studentët të mësojnë në ambiente më të përshtatshme dhe në kohën kur ata janë të lirë. Ai ua mundëson njerëzve të zgjasin kohën e edukimit të tyre nga një numër i kufizuar vitesh shkollore, pra ua mundëson arsimimin gjatë gjithë jetës. Po ashtu, mësimi online i ndryshon marrëdhëniet që lidhen me fuqinë dhe autoritetin, ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Ka barazi dhe komunikim të hapur në mes studentëve dhe profesorëve, gjë që nuk ndodh në arsimin tradicional dhe ç’është shumë me rëndësi studentët-nxënësit i rrisin mundësitë e tyre për të njohur kultura dhe përvoja të ndryshme edukative. Pedagogu kanadez, A. Bates, njëri prej ekspertëve më në zë për formësimin dhe organizimin e mësimi online, përmend këto arsye më të forta të shfrytëzimit të teknikës dhe teknologjisë moderne për mësimin online:

“- Përparohet mënyra e qasjes së të nxënësit dhe mësimi;

- Rritet dukshëm cilësia e të nxënësit dhe mësimi;
- Zvogëlohen shpenzimet e nevojshme për të nxënë dhe mësim;
- Të nxënësit dhe mësimi bëhen shumë ekonomikë;
- Përmes lidhjeve satelitore nxënësit mund të përcjellin e të zotërojnë kurse, seminare e përmbajtje nga format më të ndryshme të të nxënësit dhe mësimi nga fusha, profesionet dhe lëndët të cilat nuk i kanë në vendin ku jetojnë;
- Përmes tabelës elektronike arsimtarët mund të konsultohen me kolegët e vet në qytetin e njëjtë ose edhe në gjithë vendin;
- Rrjeti kompjuterik ua bën të mundur nxënësve nga vendet e ndryshme të mësojnë dhe bashkërisht t’i zgjidhin problemet e caktuara mësimore;
- Programet kompjuterike dhe teknika moderne telekomunikative e bën të mundur shfrytëzimin e njëhershëm të burimeve multimediale: zërin, fotografinë lëvizëse, tekstin, ilustrimin;
- Bën të mundur përparimin e nxënësve sipas tempit dhe mundësive individuale që ka”; (Bates, 2011)

1.2 E-mësimi në Republikën e Kosovës

Në Strategjinë e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, të aprovuar në tetor të vitit **2008** (SQE, 2008), parashihej edhe zhvillimi i mësimi nëpërmjet e-shkollave në Republikën e Kosovës. Aty kemi zotime të mëdha se do të fillojë implementimi i e-mësimi si nevojë e kohës për t’i përmbushur standardet e kërkuara për një arsim cilësor të pranueshëm ndërkombëtarisht. Kjo strategji nuk ia ka arritur as për së afërmi të fillojë me implementimin e saj, madje ajo është e tejkaluar për shkak se

deri më tani ajo ka mbetur një “fontanë dëshirash”. Kjo strategji parashihte që të bëjë kompjuterizimin e shkollave, të organizonte mësim online, madje të përdorte edhe e-ditarët, e-diplomat, e-mësimin, e-librezat, e-indeksat etj., për të krijuar një sistem modern, ashtu siç e parashihet Evropa dhe bota. Të mësuarit online në Republikën e Kosovës, sigurisht që mund të thuhet se është në stadin e përpjekjeve për ta filluar një gjë të tillë. Le të jemi modestë dhe ta sqarojmë të vërtetën, më shumë flitet se sa që është arritur në këtë drejtim. Se ku qëndrojnë anomalitë apo defektet në këtë drejtim, sigurisht se do të shpalosen në vijim të këtij studimi. Sistemi arsimor në Republikën e Kosovës është publik dhe privat (jopublik). Shkollat publike udhëhiqen nga strukturat shtetërore të cilët duhet të jenë përgjegjës për hartimin e politikave arsimore, megjithatë investimi vetëm në pajisjen e shkollave me teknologji informative të komunikimit do të ishte një praktikë jo e mirë. Politikat duhet të sigurojnë një vizion afatgjatë, të shpjeguara në objektiva të detajuara në një shkallë të gjerë veprimi, të “zgjerimit të aksesit për të gjithë, rritje të cilësisë së arsimit, riformim i organizimit dhe i menaxhimit të proceseve të arsimit, aftësimi për të nxënësit afatgjatë, shtimi i kompetencave të TIK-ut të nxënësve, mësuesve dhe stafit administrativ, ngritja e efektshmërisë në administrimin e shkollës”. „Çështje kryesore sipas studimeve të shumta është përqendrimi në shfrytëzimin e TIK nga mësuesit dhe nxënësit për qëllime arsimore, sesa shfrytëzimi praktik i kompjuterëve bashkë me mjetet dhe programet e tij” (Brown J. D., 1997). Kështu që, faji bartet nga institucioni në institucion, nga instancat më të larta e deri te ato shkollore, duke mos marrë përgjegjësi askush për ndryshime që i duhen vendit tonë.

Shkollat private quhen kolegje dhe ato bëjnë marketing edhe për organizimin e e-mësimin, madje edhe të m-mësimin. Krejt kjo varet sa të zëshëm e kanë marketingun. Sipas të gjeturave nga studimet e realizuara deri më tani, përmes të cilave është synuar të identifikohen faktorët me ndikim në mundësitë e sistemeve arsimore që të integrojnë teknologjinë në mësimdhënie, sugjerohet se “për të arritur rezultate pozitive në integrimin e teknologjisë mësimore kërkohet të kuptohen llojet e interaksioneve në mes të mësimdhënësve, nxënësve dhe teknologjisë” (Honey, M., Culp, K. M., & Carrigg, F., 2000). Ndryshimet në arsim është vërtetuar se mund të shoqërohen me një sërë faktorësh të tjerë, qoftë nëse ky ndryshim ndodhë për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së pandemive, duhet të ndodhë brenda një periudhe të shkurtër dhe të shpejtë ose është pjesë e reformave brenda sistemeve arsimore. Prandaj, derisa” ndryshimi definohet si krijim i diçkaje të pazakontë dhe përfshin gjithçka që është ndryshe nga normat (Flamholtz, Eric & Randle, Yvonne, 2008), kërkesa për ndryshim mund të mos jetë lehtë e pranueshme nga palët e kërkuara për ta realizuar ndryshimin, dhe mund të hasë në rezistencë. Nga të gjeturat e fushës së edukimit, përmes të cilave është analizuar gjithashtu grupi i faktorëve të cilët mund ta ndikojnë realizimin e ndryshimeve në arsim, e në veçanti

atëherë kur “është kërkuar të bëhet zhvillimi i njohurive dhe shkathtësive të udhëheqësve arsimorë, mësimdhënësve, dhe nxënësve” (Ibrahim, A., Al-Kaabi, A., & El-Zaatari, W., 2013), është vërtetuar se “niveli më i lartë i rezistencës ndaj ndryshimit ndodh në kuadër të grupeve të cilave u mungon interesimi për ndryshim, abstenojnë nga bashkëpunimi dhe dëshirojnë të ruajnë status-kuon e tyre” (Ibrahim, A., Al-Kaabi, A., & El-Zaatari, W., 2013). Ndërsa, studiues të tjerë si Palmer, Dunford dhe Akin (Palmer, I., Dunford, R., & Akin, G., 2009) potencojnë se “ekzistojnë disa arsye të tjera të cilat i inkurajojnë ose dekurajojnë njerëzit të adaptohen me ndryshimet, në kuadër të të cilave përshihen: siguria, kushtet ekonomike, autoriteti, statusi, përgjegjësia, kushtet e punës, niveli i satisfaksionit me veten, apo koha dhe përkushtimi i nevojshëm për të realizuar ndryshimin. Studime të tjera grupojnë faktorët me ndikim në rezistencën e mësimdhënësve për ndryshim, në faktorët psikologjikë, personalë, faktorët e ndërlidhur me shkollën dhe faktorët organizativë. Sipas të gjeturave nga studimi përmes të cilave janë analizuar faktorët psikologjikë të cilët mund ta ndikojnë mundësinë që mësimdhënësit të jenë pjesë e ndryshimit, përshihen paretat, të ndierët të humbur, në dyshim, dhe të shqetësuar të largohen nga ajo çfarë ata dinë dhe i bën të ndjehen rehat, në diçka që është e pazakontë dhe e paretatshme (Ibrahim, A., Al-Kaabi, A., & El-Zaatari, W., 2013)). Në këtë grup të faktorëve po ashtu përshihen niveli i stresit të mësimdhënësve, lodhja e akumuluar ose rrasapitja mendore e cila përveç se mund t’i bëjë të jenë rezistentë ndaj ndryshimit, po ashtu mund të ndikojë negativisht në performancën e tyre dhe nivelin e satisfaksionit të tyre (Margolis, J., & Nagel, L., 2006). Ndërsa në grupin e faktorëve personalë, të identifikuar si faktorë me ndikim në nivelin e refuzimit ose pranimit të ndryshimeve në sistemin arsimor, janë potencuar qëndrimet e personelit arsimor ndaj ndryshimeve, niveli i mundësive për t’u përshtatur dhe besimi që kanë ndaj ndryshimeve, moshja e mësimdhënësve, koha e pajtueshme për të inkorporuar qasje të reja në metodologjitë e tyre të punës (Flamholtz, E. G., & Randle, Y., 2008) ose mospajtueshmëritë që ata kanë në raport me strategjitë e propozuara për ndryshim (Van Veen, K., & Sleegers, P., 2006). Niveli i përkushtimit që ata kanë ndaj fëmijëve/nxënësve dhe prindërve është identifikuar të jetë gjithashtu faktor kontribues në nivelin e refuzimit ose pranimit të ndryshimeve (McKenzie, K. B., & Scheurich, J. J., 2008). Faktorët e ndërlidhur me shkollën, ose kultura e shkollës, përfshirë: mënyra se si normat dhe vlerat janë të formuara, mënyra se si puna organizohet, mënyra se si janë raportet ndërpersonale, dhe se si nevoja për ndryshim interpretohet nga shkolla, janë faktorë të tjerë të cilët supozohet të kenë ndikim në perceptimet e mësimdhënësve për ndryshimet, adaptimin ose refuzimin e tyre (Per, D., & Kitson, K., 2004). Gjithashtu, suksesi i realizimit të mësimin online, si dhe menaxhimi me sukses i ndryshimeve, është vërtetuar të ndikohet nga mënyra e ofrimit të instruksioneve dhe niveli i sqarimit të tyre, qasja dhe përshtatshmëria e pajisjeve teknologjike, koha, motivimi dhe mbështetja për të

marrë pjesë në mësimin online” (Ibrahim, A., Al-Kaabi, A., & El-Zaatari, W., 2013). Përkundër se zhvendosja e mësimin në formatin online është bërë tani pjesë e shumë sistemeve arsimore në botë, niveli i përdorimit dhe mënyra e përdorimit të teknologjisë me synim arritjen e cilësisë së mësimin online konsiderohet se mund të jetë i ndryshueshëm, dhe varet nga faktorë të shumtë, të ndërlidhur me palët e ndryshme të involvuara në realizimin e këtij formati të mësimin dhe integrimin e teknologjisë në sistemet arsimore para periudhës së ndërmarrjes së masave për mbylljet e shkollave si rezultat i pandemisë Covid-19.

1.3. Sfidat kryesore te mësimin online

Padyshim se duke parë trendin global të zhvillimit dhe të integritit të pajisjeve elektronike në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies edhe vendi jonë është prekur nga ideja e implementimit të teknologjisë informatike në mësimdhënie. Përderisa vendet më të zhvilluara tashmë e kanë të implementuar dhe rezultatet tregojnë që integrimi i pajisjeve elektronike në procesin mësimor ka sjellë shumë dobi dhe se nxënësit kanë arritur të qasen shume shpejt në metodat e mësimnxënies, vendi jonë në këtë aspekt lë shumë për të dëshiruar. Duke filluar nga infrastruktura, ku në të përfshihen pajisjet elektronike si p.sh. laptopë, tabletë, pastaj sigurimi me wireless. Trajnimi i mësimdhënësve është një element tjetër i rëndësishëm në sferën e digjitalizimit, sipas disa analizave del se mësimdhënësit nuk janë të prirur që të implementojnë mësimin digjital, por preferojnë metodat tradicionale të mësimin. Në vendin tonë Ministria e Arsimit Shkencën dhe Teknologjisë shpërndan libra falas për nxënësit e shkollave fillore dhe ata kanë shpenzuar rreth 2.5 milionë euro për libra që nga viti 2008, ku kjo vlerë është rritur shumë në vitin e ardhshëm, ku kanë shpenzuar rreth 9 milionë euro, ndërsa në vitin 2012 janë shpenzuar rreth 10 milionë euro. Plani për një implementim të një pilot projekti do të ishte mjaft domethënës për arsimin fillor në vendin tonë. Sfidë do të jetë edhe rishikimi i ndarjes së një pjese të buxhetit për të blerë pajisje elektronike siç janë tabletët, në mënyrë që të mund të implementohet një pilot projekt i tillë. Pra pjesa e blerjes së tabletëve do të mund financohet nga kursimet e mos shtypjes së librave klasik. Pastaj hulumtimi për aplikacionet edukative që mund të përdoren nga nxënësit e ciklit fillor është një sfidë tjetër e rëndësishme. Për këtë arsye ne planifikojmë të zhvillojmë një aplikacion edukativ për fëmijë, që po i njëjti aplikacion do të mund të përdoret për mësimnxënie në arsimin fillor, gjegjësisht klasor. Pra sfidat kryesore janë:

- Trajnimi i mësimdhënësve
- Infrastruktura (sigurimi me wireless)
- Ndarja e një pjese të buxhetit për blerje të pajisjeve elektronike (tabletë), që do të mund të sigurohej nga kursimet e mos shtypjes së librit klasik
- Krijimi i një pilot projekti në disa shkolla, për testim të këtij projekti .

Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxëniet. TIK-u sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie dhe i vendos nxënësit në kontroll për të nxëniet e tyre, duke lejuar progres zhvillimi të pavarur. “TIK-u, sipas Mexhuanit “si aftësi funksionale e lexim-shkrimit digjital, nxit dhe zhvillon te nxënësit një sërë aftësish të tjera, të tilla si: aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi të të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh etj. Mirëpo dukuri shqetësuese te ne është se TIK-u në masë të madhe po keqpërdoret nga nxënësit duke qëndruar orë të tëra pranë kompjuterit dhe duke e përdorur për fcb. dhe lojëra të ndryshme” (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014). Te këta fëmijë mungojnë udhëzimet konkrete në orientimin për përdorimin e drejtë të tij. Përveç familjes, që luan një rol të madh në kontrollimin e fëmijëve gjatë përdorimit të kompjuterit, rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe mësimdhënësit, të cilët me udhëzimet e tyre, mund t’i stimulojnë nxënësit që TIK-un ta përdorin për nevoja mësimore. aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi të të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh etj.

1.4.Sa janë të përgatitur mësimdhënësit për zbatimin e platformës së mësimi online?

Se arsimit dhe edukimit i një vendi është i rëndësishëm, kjo çështje është e ditur kaherë. Prandaj shumë autorë dhe studiues e kanë pasur e kanë dhe duhet ta kenë prioritet të tyre pikërisht këtë çështje fundamentale të shoqërisë. Krahas kësaj investimi në arsim është çështje me rëndësi jetike për t’i avancuar gjeneratat e reja për jetë e punë. “Përdorimi i TIK–ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxëniet, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit.” (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014). Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxëniet. Njëri nga shumë

faktorët që ndikojnë në përgatitjen e mësimeve për ta zbatuar platformën e mësimit online është edhe moshën e tyre. “Mësuesit njëzetvjeçarë hulumtojnë opsione të reja përreth vetes, ndërsa dyzetvjeçarët janë në krizën e mesit të moshës dhe gjithnjë e pyesin veten nëse janë duke punuar atë që kanë menduar dhe nëse i kanë arritur qëllimet” (Stoll, L., & Fink, D, 1996).

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësime online: e-learning,” përgatitja e mësimeve për të qenë profesionalisht i përgatitur është një proces i vazhdueshëm” (Craft A. , 2000) i cili fillon ditën e parë të punës së tij dhe mbaron ditën e fundit të punës së tij profesionale. Pra, shihet se kjo periudhë kohore është e gjatë, ndërsa ai vazhdimisht e ka obligim që të riaftësohet, të mësojë metodologji të reja, të jetë i pandalshëm në zbatimin e tyre, ashtu që nxënësi i tij gjithmonë të mësojë gjëra të reja nga ai. “Pasuria e kombit është arsimiti, prandaj shoqëria duhet t’i kushtojë gjithnjë kujdes të veçantë, meqë e ka marrë për sipër të kujdeset për arsimimin e shtetit të vet” (Winter, 2006). vazhdon t’i kushtojë rëndësi të veçantë arsimimit, kur ashpër i kritikon nëpunësit dembelë, të paafët dhe të plogëtit e një shoqërie që e shpërfillin këtë kërkesë të ligjshme të shoqërisë. *“Një mësues privat nuk mund ta shohë kurrë si të leverdishme të japë mësim në një sistem të shkatërruar dhe të vjetër të një shkence të njohur si të dobishme, apo një shkencë që mbahet përgjithësisht si një masë e kotë dhe pedante me sofizma dhe gjëra pa kuptim. Këto sisteme, këto shkencë, nuk mund të mbijetojnë në asnjë vend, përveçse në ato shoqëri të përbëra nga korporatat për arsimimin, zhvillimin dhe të ardhurat e të cilave janë në një masë të madhe të pavarura nga veprimtaritë e tyre”.* (Winter, 2006)

Natyrisht se për të gjitha këto, duke marrë parasysh se kushtet në të kaluarën kanë qenë të vështira për të arritur shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre, tani janë lehtësuar dukshëm. Zhvillimi i teknologjive të reja shihet si mënyrë jashtëzakonisht e lehtë për integrimin e mësimeve në jetën edukativo-arsimore, meqë gjithnjë kërkohet formësimi i tij. Kjo edhe më tepër e thellon arsyetimin e nevojës së mësimit gjatë gjithë jetës. Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësime dhe nxënie është një domosdoshmëri, sepse një ndër prioritetet kryesore të MASHT-it për TIK-un, të paraqitur në Planin Strategjik të Arsimit në Republikën e Kosovës 2011-2016, është edhe integrimi i teknologjisë arsimore në procesin e mësimit dhe të nxënies. Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësime dhe nxënie nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe softëare-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimit dhe të nxënies (MASHT, 2011). Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke u mbështetur në prirjet globale të jetës dhe të arsimit të sotëm, si dhe në kompetencat evropiane për arsimin (një ndër të cilat është përdorimi dhe zhvillimi i aftësive të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit), ka vendosur si prioritet të saj

integrimin e TIK-ut në mësimdhënie/nxënie. Përdorimi i TIK–ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxënit, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxënit. TIK-u sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie dhe i vendos nxënësit në kontroll për të nxënit e tyre, duke lejuar progres zhvillimi të pavarur. Pajisja e shkollave me kompjuterë ndikon në masë të madhe në përdorimin e drejtë të tij. Mësimdhënësit gjatë orëve mësimore me udhëzime të tyre dhe me këshilla konkrete kanë mundësi t’i orientojnë nxënësit në përdorimin e drejtë të kompjuterit. Por jo të gjitha shkollat e kanë një mundësi të këtillë. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vetëm nga një apo dy kompjuterë, të cilët i përdor drejtori i shkollës. Megjithatë, pavarësisht kësaj, mësimdhënësit mund të gjejnë mënyra të ndryshme për integrimin e teknologjisë si mjet pune për nevoja arsimore, qoftë me përdorimin e pajisjeve të tyre personale si: laptop, ajped, apo me shfrytëzimin e pajisjeve të kolegëve të tyre e në disa raste edhe kur vetë nxënësit sjellin në shkollë laptopët e tyre. Shpenzimi i kohës së nxënësve duke keqpërdorur kompjuterin për komunikim dhe lojëra të ndryshme mund të shndërrohet në përdorim efektiv të tij në qoftë se mësimdhënësit e integrojnë TIK-un në procesin e të nxënit, duke i udhëzuar nxënësit që të hulumtojnë për nevojat e tyre mësimore të përshtatura në kurrikulën e tyre lëndore. Qasja e mësimdhënësve duke përdorur metodën tradicionale të punës, mësuesi në qendër, dhe dhënia e informatave duke u bazuar vetëm në pjesën teorike të materialeve, është edhe një ndër faktorët që ndikon në pasivizimin e nxënësve dhe në mos stimulimin e tyre për punë. Mësimdhënësit tash e sa kohë janë tërhequr nga ideja sesi duhet të organizojnë orën e mësimi, nëse implementohet digjitalizimi i metodave të mësimdhënies. Dikur ishin radio, televizioni, kalkulatorët, kompjuterët, dhe në kohën e sotme: telefonat e mençur, tabletë, laptopë dhe tabelat interaktive. Digjitalizimi i klasave ku zhvillohet mësimi do të ndryshonte mënyrën sesi mësimdhënësit organizojnë orën e mësimi dhe mënyrën e mësimnxënies. Ndarja e buxhetit për të blerë pajisje elektronike siç janë tabletët, trajnimi i mësimdhënësve, infrastruktura në shkolla, të gjitha këta paraqesin sfida të rëndësishme për integrim të pajisjeve elektronike në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Gjithashtu sigurimi me wireless përgjatë kohës së qëndrimi të nxënësve në shkolla është qenësor. Mësimdhënësit vetëm janë trajnuar për programin ECDL. Shumica e mësimdhënësve nuk janë përdorues të TIK-ut sepse programet e trajnimeve kishin të bënin me ato programe, të cilat për mësimdhënësve ishin shumë të vështira për t’u mësuar. Mungesa e udhëzimeve të mësimdhënësve për integrimin e TIK-ut në mësim është mjaft e evidente, kështu që e vështirëson dukshëm punën me kompjuterë.

KAPITULLI II

2.1. Menaxhimi i mësimit online gjatë pandemisë Covid-19

Në këtë kohë të vështirë, sigurisht vet-izolimi, mësimi, puna nga shtëpia janë ndërlidhur mes vete. Mësimi elektronik dhe nevoja për mësim online u bë domosdoshmëri pas mbylljes së shkollave dhe universiteteve me shfaqjen e pandemisë Covid-19. Pandemia që përfshiu gjithë botën ndryshoi shumë praktika të jetës shoqërore. Shumë shkolla dhe universitete në mbarë botën, në koordinim me vendimet e shteteve të tyre, vendosën të vazhdojnë mësimet në platformën online. Sigurisht, adoptimi i një forme të re të mësimit nuk ishte i lehtë për nxënësit-studentët, profesorët dhe prindërit. Përhapja e pandemisë COVID-19 në të gjithë botën ka dërguar valë tronditëse në të gjithë sistemin e arsimit të lartë në botë. Ndërsa virusi u përhap, forma të ndryshme bllokimesh u vendosën në vendin tonë si dhe në vendet e gjithë botës. Në këtë sferë, Lorenzo (2008) shprehet se “bashkëveprimi i mësuesve dhe studentëve, ndërveprimet student me student dhe dialogjet e klasave në mjediset virtuale të të mësuarit krijojnë një mundësi që studentët të japin dhe të marrin mbështetje emocionale për njëri-tjetrin, gjë që është e rëndësishme për të mirë, ndërsa ata merreshin me pasojat e katastrofës ose ndonjë pandemie”. Në Evropë, epidemia shkaktoi vështirësi serioze në sistemin arsimor. Kjo situatë, e cila preku miliona nxënës dhe studentë në Evropë, duket se e bëri ndikimin e saj më të rëndë sidomos në shkollat publike. Turqia, është vendi i dytë pas Kinës që nisi arsim online në nivel kombëtar për miliona nxënës, pas situatës së krijuar nga pandemia e korona virusit të ri (Covid-19) që privoi nga arsimi tradicional mbi 1,5 miliard nxënës në 184 shtete.” Arsimimi online në Turqi u zhvillua ndërmjet 3 kanaleve të ndryshme televizive dhe platformës EBA. Ndërsa, për të përmbushur nevojat e përmbajtjeve të universiteteve, të gjitha kurrikulat e arsimit digjital janë të vendosura në bazat e Universitetit Anadolu, Universiteti Atatürk dhe Universitetit të Stambollit. Në Belgjikë, që është kryeqyteti i Bashkimit Evropian (BE), veçanërisht shkollat publike nuk mund të vënin në veprim një sistem të përbashkët arsimit online. Belgjika nuk arriti të zhvillonte një sistem arsimit online që mund të përdoret në të gjithë vendin. Ndërsa, shkollat private përdorën aplikacione të tilla si Zoom dhe Google Classroom, në platformën virtuale duke mbajtur kontakte me studentët çdo ditë. Në Gjermani, shumica e mësuesve komunikimin me nxënësit e tyre e zhvilluan nëpërmjet postës elektronike ku diskutoheshin edhe detyrat e shtëpisë. Ndërkaq, pas mbylljes së shkollave qeveria franceze nuk bëri asnjë përgatitje për arsimin online. Edhe pse, Ministria e Arsimit nuk ishte në gjendje të sigurojë mësuesve programe digjitale gjithëpërfshirëse për të siguruar mësim online, zhvilloi një aplikacion, ku sipas hulumtimeve vetëm 1 në 4 mësues përdornin këtë aplikacion. Në

lajmet në shtypin francez, theksohej se një numër i madh i mësuesve kishin mësim me studentët përmes aplikacioneve të tilla si WhatsApp dhe Zoom. Në Angli me pushimet e shkollave në 20 Mars u ofrua programi i BBC-së (me platformat BBC Bitesize, Iplayer BBC, BBC 4). Sa i përket vendeve të Ballkanit në përgjithësi mësimi në distance filloi pa përgatitjet e duhura. Për shkak se sistemet e arsimit mbesin ende të vjetra dhe mësuesit shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mësimin online apo edhe shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike nga ana e nxënësve. Në fakt, mësimi online në Republikën e Kosovë në kushtet e pandemisë, për klasat 1-9 u realizua nëpërmjet transmetimit të mësimave të regjistruara në televizionin publik (RTK), si dhe përmes kanalit të MASHT-it në Youtube. Shumica e shkollave dhe universiteteve filluan të punojnë me platforma të ndryshme kryesisht me instrumentet e Google (Google meeting) apo edhe përmes aplikacioneve Zoom, Skype etj., që mundësuuan komunikimin e profesorëve me studentët përmes video konferencave. Kurse në Shqipëri, “u aplikuan dy forma kryesore mësimore: leksione të xhiruara dhe të transmetuara në Radiotelevizionin Shqiptar dhe puna në mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësuuan krijimin e klasave virtuale si: Google, Classroom, Zoom etj”, (Shefkiu, 2020), (Kovaçi, 2020) Pra, mësimdhënësit dhe nxënësit u munduan që përmes platformave dhe aplikacioneve të ndryshme të zhvillojnë orët e tyre në klasat virtuale ose në distance. Këto platforma janë vetëm mjete për të zhvilluar orën e mësimin online, metodologjitë, shpërndarjen e syllabuseve të lëndëve, apo edhe të krijojnë arkivin elektronik të të gjithë literaturës të detyrueshme që nxënësit i duhet për të përvetësuar lëndën. Një nga mekanizmat më të forta të këtyre platformave janë edhe video-konferencat, të cilat mundësojnë komunikimin direkt me të gjithë klasën. Po ashtu, këto aplikacione mundësojnë mësuesve/profesorëve të shoqërojë shpjegimin e mësimin edhe me burime të jashtme si video apo dhe prezantime duke e bërë mësimin më atraktiv. Gjithashtu edhe në shkollat e Lipjanit me rrethinë mësimi u ndoq përmes kanalit publik të RTK-së, që përveç kësaj, shumë mësimdhënës punuan edhe klasat virtuale që i krijuan përmes platformave digjitale si: Google, Classroom, Zoom, Viber, Msn.

2.2. Mbyllja e shkollave dhe organizimi i mësimin online në Republikën e Kosovë

Masat parandaluese të shpallura nga Qeveria e Republikës së Kosovës kundër përhapjes së Covid-19 të datës 12 mars 2020 e kanë ndikuar jetën dhe arsimimin e rreth 450,146 nxënësve dhe studentëve, dhe afro 30,528 mësimdhënësve dhe profesorëve në Republikën e Kosovës (MASHTI, 2020), (ASK, 2019). Ditë më pas, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në

bashkëpunim me akterët e tjerë, përfshirë drejtoritë e arsimit në nivel komunal, dhe organizatat joqeveritare, filloi planifikimet për mësimin online për fëmijët e grupmoshave të caktuara, dhe për lëndë të veçanta (gjuhë dhe matematikë). Javë më pas, mësimi në edukimin parauniversitar publik, mësimi online filloi me prezantimin e video-incizimeve të transmetuara në televizionin nacional, përmes të cilave prezantoheshin mësim nga mësimdhënës të përzgjedhur, për lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës, për nxënësit e klasave 1-5. Alternativa të tjera nuk potencoheshin të jenë në dispozicion të nxënësve, përveç se përfaqësues të të njëjtit institucion në vazhdimësi informonin përfituesit e sistemit arsimor për të rejtat të cilat priteshin në javët në vazhdim; se do të organizohet mësimi sipas të njëjtit format edhe për nxënësit e klasave 6-9, dhe më vonë edhe për klasat më të larta, shkollat e mesme dhe shkollat profesionale (MASHTI, 2020). Më tutje, në kuadër të planifikimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për planifikimin e mëtutjeshëm të mësimin online u publikuan edhe detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin, përmes të cilave specifikohet roli i secilës palë të angazhuar në institucionet edukativo-arsimore parauniversitare në vend. (MASHTI, 2020). Në javët në vazhdim mësimi online filloi së zbatuari edhe për nivelet 6-9 në të gjitha lëndët, përveç atyre të shkathtësisë.

2.3. Organizimi i mësimin online nga mësimdhënësit e komunës së Lipjanit

Nxënësit, pedagogët kanë nevojë për ta ndërë auditorin, duhet t'i japin shpirt dhe zemër dijes që përcjellin për të frymëzuar të rinjtë, për t'i ndriçuar me modelin e profesionistit, ku ata duhet të projektojnë të ardhmen e tyre. Sigurisht, këto ndjesi nuk mundet t'i ofrojë teknologjia, e cila padyshim ka avantazhet e saj dhe në kushtet në të cilat u ndodhën mësimdhënësit e komunës së Lipjanit me rrethinë, por edhe të gjithë të tjerët në Republikën e Kosovës, ishte mënyra e vetme që i mbajti lidhur nxënësin me mësimdhënësin me procesin mësimor.” Edhe në kohë më të vështira, gjatë uzurpimeve të mjediseve shkollore në vitet e 90-ta, mësimdhënësit shqiptarë kanë gjetur forma për të vazhduar rrugën e nxënies për më të vlefshmit e tyre, nxënësit dhe studentët. Tani kur po përballemi me një rrezik tjetër, me një armik të padukshëm, mësuesit përsëri gjetën rrugëdalje për t'u ballafaquar edhe me këtë sfidë, duke u mësuar fëmijëve që mësimi nuk duhet ndaluar as atëherë kur humbet mundësia, as atëherë kur ndalet drita, as atëherë kur s'kemi bankë dhe tabelë”. (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020)

Sipas Duraku dhe Hoxha “me sfidë të ngjashme Republika e Kosovës ishte përballur gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur organizoi mësimin paralel, një shembull unik i mobilizimit qytetar për të

mbajtur sistemin arsimor gjallë në kohë të konfliktit dhe luftës. Në kohë paqeje, për shkak të Pandemisë COVID-19, mësimi u organizua online në forma të ndryshme. Me një mobilizim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), e-mësimi i regjistruar për klasat 1-9 u shfaq në RTK dhe Youtube. Gjithashtu mësimi u zhvillua dhe u organizua edhe përmes platformave Moodle, Google classroom, Google Meet, Zoom dhe Wiber. Vështirësi të theksuar patën shkollat fillore dhe te mesme publike, për shkak të mungesës së digjitalizimit duke përdorur aplikacionet Viber, Wehatsapp e Facebook për dorëzimin e detyrave”. (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020).

Në bazë të përvojës si dhe komunikimit me kolegët dhe hulumtimit të bërë për këtë punim diplome, të gjithë mësime të Komunes së Lipjanit me rrethinë u angazhuan që të krijojnë kontaktin me nxënës duke krijuar grupet në platformat online. Shumica e mësimeve i udhëzuan nxënësit dhe prindërit e tyre që ta përcjellin kanalin e RTK-së dhe pas përfundimit të të gjitha orëve mësimore dorëzimi i detyrave të bëhej në kohë të caktuara, për arsye që nxënësit të kenë mundësi t’i përkushtohen secilës lëndë dhe të shmangej mbingarkesa e tyre me detyra. Pasi që u krijuan grupet e nxënësve në platforma online menjëherë u paraqitën edhe problemet e para gjë që i përcolli deri në fund të vitit shkollor. Krahas vështirësive të paraqitura ishte edhe një entuziazëm që kontakti me nxënësin dhe anasjelltas ishte një urë lidhëse në mes tyre. Drejtoria Komonale e Arsimit e Komunes së Lipjanit u kërkoi mësimeve angazhim tejet të theksuar që të ketë në qendër nxënësin dhe të organizojnë një program që është në përputhje me kurrikulën, por në kushte të tjera. Në lidhje me këtë, duhet të bëheshin përpjekjet maksimale që mësimi të mos dështojë, dhe rrjedhimisht mos të anulohet viti shkollor, por që të gjenden mekanizma të cilat do të jenë të përshtatshme për kushtet e pandemisë. Aplikimi i plotë i mësimit online në nivelin parauniversitar përbën një problem në socializmin e nxënësve. Duke pasur parasysh moshën e tyre, kjo ishte një çështje delikate, sepse në këtë moshë çdo fëmijë ka nevojë të rrijë dhe të komunikojë me bashkëmoshatarët e vet, mirëpo socializmi i tyre ishte i domosdoshëm, ka frymëzuar dhe ngjallur reagim pozitiv të të gjitha moshat. Përdorimi i kompjuterit, kontakti me mësimeve të tyre, afërsia dhe gatishmëria e nxënësve, që treguan ishte edhe përparësi për nxënësin, duke e zvogëluar kështu monotoninë që u shkaktoi izolimi në shtëpi. Kjo iniciativë e tillë do të rezultojë edhe në parandalimin e braktisjes së shkollimit. Për të ecur drejt inovacioneve, për të zhvilluar punën e pavarur kërkuese, shkencore, krijimi i kushteve për mësim online ishte një pikë e fortë dhe e pakapërcyeshme e mësimeve dhe nxënësve për të arritur synimet e caktuara.

Edhe pse pati kritika nga mësime të kësaj komune që u parashtruan për përdorimin e platformave, planit mësimor i hartuar nga aktivet profesionale të secilës fushë kurrikulare të cilat nuk përputheshin me atë të zhvilluar përmes kanalit të RTK-së, vështirësitë për qasje në këto platforma nga grupet e marginalizuara dhe mungesa apo mospërfshirja e të gjithë nxënësve dhe mësime të mënyrë dhe nivel të njëjtë, megjithatë mësimi online konsiderohet i suksesshëm kundrejt faktit që pandemia i gjeti institucionet arsimore fare të papërgatitur. U debatua mënyra e dorëzimit të detyrave, leximit dhe angazhimit të nxënësve, zbatimi i mundësisë së shkollimit nga shtëpia i cili parashihet me ligj, por në të njëjtën kohë vështirësia e njohjes së mësimi për shkak të mungesës së përvojës dhe mekanizmave të mbikëqyrjes dhe verifikimit në këtë drejtim ishte sfiduese. (MASHTI, 2020)

Përveç transmetimit të mësimi nga kanali i televizionit publik RTK-së, një pjesë e mësime të Komunës së Lipjanit, mësimin e zhvilluan përmes platformave të tjera të cilat konsideroheshin më të përshtatshme për ta organizuar dhe zhvilluar mësimin sepse mësimet e ndjekura nga ky transmetues publik nuk i plotësonin as për së afërmi kërkesat e të nxënësve. Organizimi rreth orarit të mbajtjes së orëve mësimore u realizua në pajtueshmërinë e mësime të nxënësve dhe nxënësve që një lëndë mësimore mos të qëllonjë në të njëjtën kohë me lëndët e tjera, por duke pasur gjithmonë parasysh orën e caktuar për lëndën mësimore përkatëse. Në marrëveshje, mësime të hartuar një orar duke iu afruar orarit shkollor që edhe nxënësve ta kenë mundësinë dorëzimit të detyrave, që pastaj nga i gjithë angazhimi i nxënësve të vlerësohet procesi i të mësuarit. Metoda e mësimi, bashkëpunimit me kolegë, koordinimit të orarit mësimor përmes platformave online ka rezultuar me vlerë, veçanërisht në këtë kohë të vështirë për të gjithë.

“Të gjithë jemi dëshmitarë të zhvillimit të shpejtë të rrjeteve kompjuterike, këto zhvillime e kanë bërë kompjuterin një forcë dinamike për mësimin online, që siguron një mënyrë të re dhe ndëraktive të pakësimit të distancës dhe të kohës për të arritur te nxënësve”. (Saba, 2015). Kompjuteri dhe pajisjet e tjera teknologjike janë një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e mësimi online gjë që në të kundërtën e vështirëson dhe e bën të pamundur aplikimin e këtij lloji mësimi. Kur e themi këtë duhet ta kemi parasysh numrin i fëmijëve në një familje, sepse jo të gjithë nxënësve në një familje kanë qenë të pajisur secili me pajisjet teknologjike. Secili mësime ka pasur parasysh që në familjet e nxënësve kanë pasur në dispozicion një laptop apo një “telefon të mençur”, gjë që ka vështirësuar punën dhe bashkërenditjen e orarit të caktuar mësimor. Të gjithë akterët të përfshirë në këtë proces mbesin në dilemë të madhe se cili nga fëmijët do ta përdorë kompjuterin apo telefonin për t’i dëgjuar mësimet apo për të sqaruar paqartësitë e paraqitura në procesin e nxënies. Megjithatë sipas mësime të, kontakti i drejtpërdrejtë (përmes platformave të tjera si Zoom, Meeting) me

nxënës duket të ketë qenë më efikas sepse edhe dorëzimi i detyrave, ora e tipit përsëritje zhvillohej dhe ishte më atraktive, por edhe nxënësi, mësimitdhënësi dhe prindi nuk ndjehej i ngarkuar më pastaj sepse të gjitha objektivat mësimore përmbledheshin dhe përfundonin brenda afatit 45 minutash sa zhvillohej ora mësimore.

2.3.Paisjet dhe platformat teknologjike të zhvillimit të mësimit online

Numri më i madh i fëmijëve të Komunës së Lipjanit me rrethinë kanë ndjekur mësimin online përmes paraqitjeve të orëve mësimore në televizionin publik. Një grup i tyre, përveç mësimeve në televizion, kanë realizuar edhe mësim online, me mësimitdhënësit në platforma online dhe/ose në Viber. Ndërsa, komunikimi i prindërve me mësimitdhënësit është realizuar kryesisht përmes Viber-it, Email-it ose Skype-it. Të zgjedhësh metodën e saktë të mësimit është si të zgjedhësh veglën e duhur për punë. Metodatat e mësimit, e sidomos metodatat më bashkëkohore, përmes teknologjive të komunikimit që i kanë përfshirë shkollat e komunës në fjalë, sepse është e rëndësishme që përmes mësimit të zhvilluar në këtë mënyrë nxënësit, por edhe mësimitdhënësit kanë hequr mendjen dhe situatat stresuese që shkaktoi izolimi dhe frika nga epidemia. Gjithashtu nga ana tjetër, e sigurojnë mjetin të cilin mësimitdhënësit dhe nxënësit do ta përdorin për të arritur objektivat e mësimitdhënies dhe nxënies, si dhe rrisin procesin e mësimit duke i mbajtur nxënësit të angazhuar dhe të interesuar në hulumtime për mësim. Komunikimi i tyre bëhej për tema të caktuara përmes platformave digjitale që më e suksesshmja konsiderohej platforma Zoom. Përmes kësaj platforme që konsiderohej më e përshtatshme nxënësit dhe mësimitdhënësit kishin mundësinë që orën e mësimit ta zhvillonin në mënyrë shumë efektive sepse të gjithë nxënësit mund të flisnin dhe komunikonin me zë dhe me video. Edhe pse mungonte vetëm kontakti fizik, arti i komunikimit publik, gjuha e trupit, gjestikulacioni, pesha e fjalës, sugjestionimi dhe ngjallja e empatisë tek auditori ishin detaje, të cilat nuk mund të qaseshin në mënyrë efektive në mësimin online, që gjithsesi ishte më i ftohtë dhe më i ngurtë. Dërgimi i aty për aty i porosive bëhej edhe me Messenger, Viber, 'Google Talk', 'Skype', komunikim të sinkronizuar elektronik, me tekst me zë dhe me video. Përfitimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve ishin se mund të kenë punë me platforma të ndryshme, qartësim të përmbajtjeve, mësim të gjuhëve të huaja, rrjetëzim social, përkrahje të detyrave të shtëpisë dhe bashkëpunim edhe me shkollat të tjera.

Realizimi i mësimit online dhe online dhe qëndrimi në shtëpi, sipas perspektivës së prindërve, ka ndikuar pozitivisht, duke i ndihmuar ata të angazhohen rreth shtëpisë, të shpërqendrohen nga situata, si dhe të kalojnë kohë kualitative me fëmijët. Sidoqoftë, sipas perspektivës së prindërve,

fëmijët e tyre (nxënësit) nuk e shohin vijimin e mësimimit online si obligim dhe janë të pakënaqur. Po ashtu, ndryshimi në ndjekjen e mësimimit ka sjellë angazhime shtesë për prindërit, qoftë në monitorimin e fëmijëve gjatë mësimimit online, por po ashtu edhe në komunikimin me mësimdhënësit. Ata, po ashtu kanë potencuar se angazhimet rreth detyrave të shtëpisë dhe angazhimet rreth mësimimeve të fëmijëve të tyre u kanë shkaktuar ngarkesë tepër të madhe.

Pajisjet teknologjike që përdoren nxënësit dhe mësimdhënësit gjatë zhvillimit të mësimimit online ishin llaptopët, Smart-telefonë, tabletë etj., kurse platformat më të theksuara që patën në dispozicion ishin MSN, Viber, Zoom, Google classroom, Email, ‘Voip - Voice over IP’

Zoom është një aplikacion që mund të instalohet në telefona të mençur dhe kompjuterë, ku më shumë se dy persona mund të komunikojnë përmes kamerës me zë. Ky aplikacion është duke u përdorur në shumë vende të botës për mësimime online përkundër disa paralajmërimeve se mund të mos jetë komunikim i sigurt. “Përmes aplikacionit ‘Zoom’ të gjithë nxënësit kanë mundësinë të shprehin paqartësitë që i kanë, bëhen teste online në lidhje me ato njësi të cilat shpjegohen dhe besoj që ka anën shumë pozitive. Përveç këtyre është një mënyrë pak më atraktive se ajo e zakonshme dhe ngjallte shumë kureshtje tek nxënësit. (Ray, 2020)

Messenger- përmes kësaj platforme, përdoruesit mund të dërgojnë mesazhe dhe të shkëmbejnë foto, video, afishe, audio dhe skedarë, si dhe të reagojnë ndaj mesazheve të përdoruesve të tjerë dhe të ndërveprojnë me botë. Shërbimi gjithashtu mbështet thirrjen me zë dhe video. (Ruddock, 2013). Kjo platformë u përdor nga nxënësit dhe mësimdhënësit për të shkëmbyer informacionet rreth detyrave dhe paqartësive që kishin nxënësit rreth mësimimeve të ndjekura, qoftë nga kanali i televizionit publik apo dhënies së detyrave nga mësimdhënësit

Viber- ky aplikacion është përdorur shumë nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Nxënësit/studentët kanë dorëzuar detyrat përmes kësaj platforme si dhe në shumicën e rasteve është përdorur për të kontaktuar me prindërit për sqarime të nevojshme. Viber ka mundësinë të instalohet në telefon dhe kompjuterë.

‘Voip-Voice over IP’ (VOIP): është mekanizëm për telefonatat që bëhet përmes lidhjes broadband të internetit. Skype në arsim, mundëson që mësimdhënësit të bëhen rrjet me mësimdhënësit e tjerë të teknologjisë për dhënien e udhëzimeve, lidhjen e nxënësve /studentëve me ekspertët në mbarë botën, lidhjen e nxënësve/ studentëve që mësojnë lëndë të ngjashme apo të ndërlidhura. Përveç kësaj, ekipet e mësimdhënësit mund të takohen virtualisht, dhe prindërit mund t’i shohin nxënësit/studentët e tyre

duke prezantuar. Edhe ky aplikacion duket të ketë qenë një platformë mjaft e suksesshme në kontakt me nxënësit. (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014)

E-mail-i: përmes e-mail-it mund të bëhet shpërndarje më e shpejtë e përmbajtjeve të ndryshme mësimore, grafike e ilustruese grupit apo individit. Përdorimi i tij mund të bëhet vetëm në mjediseshkolla me rrjet, internet të instaluar. E-maili siguron komunikim më të shpeshtë midis pjesëmarrësve në arsim. Edhe kjo platformë ka qenë mjaft e përdorshme nga mësimdhënësit dhe nxënësit. (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014)

TV kablovik: Televizori ndihmon në konkretizimin e informacionit, e bën më të prekshëm atë dhe shmang monotoninë gjatë përvetësimit. Marrja e informacioneve të nxënësve përmes TV kablovikut bëhet përmes shumë shqisave. Këto informacione mund t'i marrë njëherazi grupi i nxënësve ose edhe individualisht. Koha e imitimit të emisionit është në kohën e caktuar. Emisioni mund të incizohet (regjistrohet dhe shfrytëzohet më vonë). Bashkëveprimi mund të jetë i kufizuar midis pjesëmarrësve në mësim. (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014)

Telekonferencat/konferencat-telefonike: përmes telekonferencave dhe konferencave telefonike mund të bëhet komunikimi dhe inkuadrimi individual dhe grupor i nxënësve dhe mësimdhënësve. Koha e shfrytëzimit është e kufizuar dhe marrja e informacioneve nga nxënësit/studentët bëhet përmes shumë shqisave. Mundësia e komunikimit mund të bëhet në një ose dy drejtime.

Bisedat me anë të kompjuterit: bisedat përmes kompjuterit kombinojnë informacionet gojore, konceptuale, vizuale dhe auditive, duke mundësuar një qasje komplekse dhe të afërt me realitetin. Për realizimin e këtyre bisedave janë të nevojshme: modemi, linja telefonike për lidhjen e kalkulatorit dhe kamera e vogël. Të gjitha këto e bëjnë të mundur dërgimin e gjithë materialit mësimor në vende të ndryshme dhe bashkëbiseduesit mund të kenë edhe kontaktin vizual. (Mexhuani, Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, 2014)

2.4.Vlerësimi i mësimdhënësve për mësimin online, sfidat dhe mundësitë

Sipas mësimdhënësve të komunës së Lipjanit në kuadër të faktorëve të cilët mund ta kenë ndikuar cilësinë e realizimit të mësimin online, më saktësisht planifikimet për procesin mësimor, ndërveprojnë me faktorët organizativë: përfshirë nivelin joadekuat të bashkëpunimit në mes të udhëheqësve të shkollës, dhe organizimin e dobët në shpërndarjen e informacioneve tek mësimdhënësit. Sidoqoftë, ata po ashtu kanë potencuar se përgjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të mirëfilltë në mes të mësimdhënësve. Ndërsa në raport me orët mësimore të

prezantuara përmes televizionit publik, ata shprehin skepticizmin e tyre, konsiderojnë se ishte i shkurtër dhe i paqartë, dhe se orët mësimore të prezantuara nuk ishin në përputhje me planprogramin e realizuar nga ta përgjatë punës në shkollë. Për më shumë, “në kuadër të shqetësimeve të potencuara për mësimin online, shprehin dyshimet për çështjet teknike të cilat mund ta pengojnë procesin, dyshimet nëse do të pranohet kjo formë nga nxënësit, dhe se pjesëmarrja e nxënësve herë-herë ishte e ulët” (Anxhela, 2020). Ndërsa shqetësimet e tjera ndërlidhen me konfuzitetin e tyre në lidhje me mënyrën se si do të vlerësohen nxënësit. Për mësimdhënësit, si sfiduese për mësimin online në vazhdim do të jetë numri i nxënësve pjesëmarrës, komunikimi i shpeshtë me prindërit, dhe se nxënësit, e poashtu edhe mësimdhënësit kanë vështirësi në përdorimin e pajisjeve teknologjike. Sidoqoftë,” ata sugjerojnë se për t’u avancuar mësimi online, mësimdhënësit duhet ngritur në nivelin e njohurive dhe shkathtësive të tyre për teknologjinë, si dhe duhet rritur niveli i interaksioneve me nxënësit përgjatë zhvillimit të mësimin online” (Mexhuani, Kërkime pedagogjike, 2011). Numri më i madh i mësimdhënësve kanë deklaruar të jenë të motivuar të vazhdojnë me realizimin e mësimin online, dhe si faktor kontribuues të ketë ndikuar në këtë motivim është shprehja e mirënjohjeve dhe falënderimeve nga familjet e nxënësve. Sidoqoftë, në grupin e faktorëve rrezikues, të cilët është vërejtur të kenë ndikuar në mungesën e motivimit tek ta, është mungesa e prezencës fizike të nxënësve, dhe dyshimet se rezultatet nga mësimi në këtë format nuk do të jenë të njëjta sikurse nga mësimi në shkollë. Gjithashtu sfidë mund të konsiderohet edhe koha që duhet përgatitur dhe të gjetja e përmbajtjeve mësimore që do ta bënin mësimin më të lehtë për të gjithë. “Në mungesë përvoja, jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe në vendet tjera, nuk mund të thuhet asgjë për efektet e mësimin online te nxënësit. Nuk e dimë sa janë duke i përcjellë nxënësit videot që po transmetohen në kanale televizive dhe sa janë duke punuar në përmbushjen e detyrave. Kjo do të kuptohet vetëm atëherë kur të jetë vendosur kontakti i drejtpërdrejtë në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve.” (mësimdhënësit). Gjithashtu, përkundër rrethanave aktuale me të cilat është duke u ballafaquar e gjithë bota për shkak të Covid-19, zhvillimi i procesit mësimor online, përveç se mund të ndikojë pozitivisht në mbështetjen e qytetarëve që ta tejkalojnë më lehtë periudhën e izolimit, po qe se zhvillohet duke marrë për bazë faktorë të cilët mund ta avancojnë cilësinë e arsimit, ky realizim mund të ketë efekte pozitive afatgjate meqë, siç potencohet nga studimet e mëparshme, mirëqenia e nxënësve ndikohet nga cilësia e mësimin. Rezultatet e studimit nxjerrin në pah nivelin e shqetësimeve dhe ndryshimeve të tjera tek (nxënësit) fëmijët dhe familjet.” (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020)

Sfidat që mund të dalin në këtë proces mund të jenë të shumta për mësimdhënësit dhe nxënësit, e sidomos ata që jetojnë në pjesët rurale që nuk kanë pasur qasje më herët në internet, por edhe rrjet

të dobët interneti, gjithashtu edhe për nxënësit që mund të kenë mungesë të pajisjeve teknologjike, mungesë të udhëzimeve, dhe nxënësit që kanë pasur vështirësi në të nxënë edhe në formën klasike. Sipas Mexhuanit, “Mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë mësues-nxënës, mungesa e komunikimit, ku mësimsdhënësit nuk mund të mbështetën në shenjat jo verbale për ta konfirmuar nëse informacioni është transmetuar tek nxënësit, nëse janë të vëmendshëm dhe e kanë kuptuar materialin mësimor. Mungesa e mekanizmave për të vendosur rregull dhe disiplinë në një orë mësimore në mënyrë që nxënësit të tregojnë respekt ndaj mësimsdhënësit dhe disiplinë në klasë . Vendosja e materialeve të shumta nga mësimsdhënësit pa orar të caktuar, ngarkimi me detyra të shtëpisë më shumë se sa mund të bëjnë në këto kushte mund të krijojë stres te nxënësit. Hulumtimet tregojnë se materialet më të shkurta dhe audio/video prezantimet jo më shumë se 10 minuta, janë më të favorshëm që nxënësit t’i lexojnë dhe t’i ndjekin ato, por në anën tjetër edhe jo të mjaftueshme. Anashkalimi në kryerjen e detyrave mund të rrjedhë nga mungesa e prezencës fizike në klasë” (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020). Mundësia e kopjimit nga ana e nxënësve në zgjedhjen e detyrave, testeve, vlerësimi i njohurive të nxënësve janë disa prej të metave të mësimin online. Ishte shumë e vështirë të shpjegosh ushtrimet matematikore nëpërmjet internetit. Si lëndë ekzakte që është, do shumë përqendrim dhe punë nga të dyja palët. Pavarësisht videove të mësimsdhënësve të shkencave shpjeguese, por edhe videove në YouTube apo RTK-së, në fund të ditës nxënësit dukeshin shumë të paqartë. Si çështje e diskutueshme ishte cilësia e materialeve në e-mësim dhe niveli i përfshirjes së shkollave dhe mësimsdhënësve në proces duke theksuar problemet e organizimit. Një nga masat e ndërmarra nga mësimsdhënësit gjatë testimit të nxënësve ishte përdorimi i një sistemi, ku nxënësi duhej të identifikohet duke shfaqur identitetin(fytyrën) para kamerës, pastaj të skanojë dhomën që të sigurohej se askush nuk është i pranishëm dhe të skanojë tavolinën e punës që të sigurohej se nuk ka libra dhe pastaj të fillojë testi. Procesi vëzhgohej në kamera dhe gjithçka incizohej në rast se ishte e nevojshme që të shqyrtohet më vonë.

Sipas perspektivës së prindërve, përgjatë periudhës së izolimit, fëmijët janë vërejtur të kenë ndryshime në sjellje, të jenë të frikësuar, të kenë treguar shenja paniku, të dëshpëruar, të stresuar, të frikësuar, të shqetësuar, konfuzë dhe pasivë. Ndryshime dhe nivele të ndryshme të shqetësimeve janë vërejtur edhe në kuadër të familjes: përfshirë rritje të niveleve të ngarkesës dhe brengosjes, frikë të shtuar, presion, dhe ndryshime në ritmet e gjumit (Pajaziti, 2020). (Jajaga, 2020). Numri më i madh i fëmijëve kanë ndjekur mësimin online përmes paraqitjeve të orëve mësimore në televizionin publik. Një grup i tyre, përveç mësimin në televizion, kanë realizuar edhe mësim online, me mësimsdhënësit në platforma online dhe/ose në Viber. Ndërsa, komunikimi i prindërve me mësimsdhënësit është

realizuar kryesisht përmes Viber-it, email-it ose Skype-it. Një sfidë tejet e theksuar është vërejtur te mësuesit e moshuar zakonisht nuk dinë as të përdorin aplikacionet themelore siç janë Skype ose Viber” ose platforma të ndryshme, kështu që mund t’i imagjinojmë vetë problemet. “Sistemet e arsimit në Ballkan shpesh janë të vjetra dhe mësuesit shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e mjeteve teknologjike për të kaluar në mësimin online. Kjo ka ekspozuar pabarazi të mëdha midis dhe brenda vendeve, midis shkollave private dhe publike dhe qyteteve dhe fshatrave për sa i përket njohurive dhe burimeve në dispozicion”. (Mariç, 2020). Shumë mësues, nxënës dhe prindër janë gjendur përballë programesh të panjohura, pajisjesh të vjetruara ose jo-ekzistuese dhe, në shumë raste, me lidhje interneti të dobëta. Disa fëmijë e gjejnë veten të përjashtuar plotësisht. Fëmijët shpesh duhet të përdorin celularin ose laptopin e një prindi, i cili nuk është gjithmonë në lartësinë e kësaj detyre. “ Realizimi i mësimin online dhe online dhe qëndrimi në shtëpi, sipas perspektivës së prindërve, ka ndikuar pozitivisht, duke i ndihmuar ata të angazhohen rreth shtëpisë, shpërqendrohen nga situata, si dhe të kalojnë kohë kualitative me fëmijët” (Qirezi, 2020) .Sidoqoftë, sipas perspektivës së prindërve, fëmijët e tyre (nxënësit) nuk e shohin vijimin e mësimin online si obligim dhe janë të pakënaqur. Po ashtu, ndryshimi në ndjekjen e mësimin ka sjellë angazhime shtesë për prindërit, qoftë në monitorimin e fëmijëve gjatë mësimin online, por po ashtu edhe në komunikimin me mësimeve të fëmijëve.” Ata, po ashtu kanë potencuar se angazhimet rreth detyrave të shtëpisë dhe angazhimet rreth mësimeve të fëmijëve të tyre u kanë shkaktuar ngarkesë. Sipas tyre, kohëzgjatja e shkurtër e njësive mësimore, paqartësia e detyrave, mossinkronizimi i njësive mësimore të prezantuara në televizion me mësimet e realizuara nga nxënësit në shkollë, mungesa e lëndëve të tjera, përveç atyre bazike, ambienti i shtëpisë, niveli i arsimit të prindërve, dhe mungesa e kushteve fizike, dhomave të ndara, janë konsideruar faktorë të cilët e kanë penguar cilësinë e mësimin të realizuar deri më tani”. (Ruçi, 2020). Sidoqoftë, ata po ashtu kanë vlerësuar si përparësi organizimin e mësimin online dhe shpejtësinë në realizimin e tij, dhe rekomandojnë që përgjatë zhvillimit të mëtutjeshëm të mësimin online do të ishte me rëndësi përmirësimi i ndërveprimit në mes të mësimeve dhe prindërve, përmirësimi i mësimin online, dhënia e sqarimeve më të mira për detyrat dhe sqarimi i metodave të vlerësimit të nxënësve.

2.5. Epërsitë dhe mangësitë e menaxhimit të mësimit online

“Institucionet arsimore kanë ndërmarrë një hap të rëndësishëm rreth ofrimit të mundësisë për vazhdimin e mësimit në një formë ndryshe nga ajo më të cilën jemi mësuar. Të mësuarit online përmes platformave të ndryshme ishte e vetmja mundësi që në një situatë pandemie nxënësit të jenë në kontakt me mësuesin dhe në hap me mësuesin”. (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020). Nëpërmjet edukimit online, ku nxënësit dhe mësuesit i bashkon teknologjia, komunikimi nxënës-mësues ndodhë në kohë reale, mësuesi shpjegon, plason informata të drejtpërdrejta, ofron detyra, pret përgjigje, të gjitha këto janë indikatorë se mësimi virtual ishte i realizueshëm dhe mund të ishte si formë e mësimit me dobi të veçantë sidomos në kushte emergjente.” Pavarësisht se ku zhvillohet mësuesia, në klasa tradicionale, apo në klasat virtuale, gatishmëria nga mësuesin për të punuar dhe nga nxënësit për të mësuar është gjëja më e rëndësishme që mund të bëhet për të na motivuar tutje. Sistemi arsimor ka të meta edhe në formën klasike, megjithatë është një hap i mirë, që nxënësit të mos mbesin mbrapa me mësime. Kjo formë e mësimit edhe pse po krijon stres te mësuesin dhe nxënësit, në anën tjetër përkushtimi i tyre në punë dhe në mësime, ndikoi pozitivisht në largimin e stresit dhe panikut ndaj sëmundjes Covid-19 e cila e ka përfshirë tërë botën.” (Duraku, H., Zamira & Hoxha, Linda, 2020)

Mësimi online hapi mundësi edukative, duke lejuar që nxënësit të mësojnë nëpërmjet platformave të sigurta të edukimit, ku nxënës e mësuesin ndërveprojnë e komunikojnë njëllë si në një klasë tradicionale edhe pse si e metë e saj është kontakti fizik. Si përparësi ishte që mësuesin dhe nxënësit kishin komoditet që të qasen nga cilido vend, të marrin mësime të tyre edhe pa praninë e tyre fizike. Gjithashtu, mësimi online i ndryshoi marrëdhëniet, ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, komunikimi mësues- nxënës është më i hapur, gjë që nuk ndodh në arsimin tradicional. Ndërveprimi dhe angazhimi mund të shihet edhe nga nxënës të tjerë, të cilët në klasë kanë qenë më pak aktiv, më introvertë dhe kanë hezituar të përgjigjen para masës, ndërsa mësimi virtual ua bëri më të lehtë këtë. Si përparësi tjetër ishte avancimi në përdorimin e pajisjeve teknologjike të mësuesin, si mundësi që në të ardhmen secili prej mësuesve të ndryshoj vetveten. Mësuesin filluan të komunikojnë dhe të konsultohen më shumë me kolegë rreth punës së tyre më lehtë dhe më shpejt, dobësi kjo që ishte vërejtur në kushtet e normalitetit.

“Gjithnjë duhet ta kemi parasysh se mësimi online zhvillohet në kushte të pandemisë, kur mundësia për t’i mbështetur dhe mbikëqyrur shkollat është më se e kufizuar. Në këto kushte, nuk përjashtohet mundësia të ketë shkolla ku procesi ngeçë ose nuk zhvillohet si duhet.

Vet natyra e mësimit online dallon nga mësimi në klasë dhe kërkon një pavarësi më të madhe nga nxënësi dhe mbikëqyrje të shtuar nga prindi, që nuk ndodhë gjithnjë. Prandaj, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se edhe mund të ketë rënie të rezultateve të nxënësve në raport me vitet e kaluara, kur është punuar në kushte normale” (Kovaçi, 2020)

Në anën tjetër, mësimi online mund të jetë paradoks për faktin që përdorimi i teknologjisë po shihet si sfidë nga mësimdhënësit, pasi shumë para janë dhënë për suksesin i mësimit online dhe këtu, vihet në pah problemi nga paaftësia profesionale e individëve pjesë e sistemit të punësuar pa meritorkaci, që në një moment duhet të vëzhgojnë punën shume komplekse të mësimdhënies. “Në mungesë të kësaj, atëherë në shumë nga raportimet nga DKA e drejtor shkollash do të kemi statistika të fryra të pjesëmarrjes në mësimin online, pra, numra për paraqitje të mirë, mirëpo jo numra si dëshmi për mësimdhënie të mirë, paraprakisht për trajnimin e mësimdhënësve në fushën e informatikës.” (MASR, 2020)

Mund të themi që vërtetë mësimi online ishte sfidues, për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, mirëpo si përparësi ishte që viti shkollor përfundoi me sukses duke arritur të gjitha objektivat mësimorë dhe vlerësimin e nxënësve poashtu. Ishte një mundësi e mirë që u organizua mësimi online që si rrezik mund të paraqitej humbja e vitit shkollor. Edhe pse mësimi online nuk i plotësoi të gjitha nevojat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si mundësi e mirë ishte që nxënësit të ishin interaktiv dhe t’i iknin stresit gjatë izolimit në shtëpi, por që si dobësi mund të potencojmë qasjen dhe përfshirjen jo të barabartë të të gjithë nxënësve në mësimin online për shkak të pajisjeve teknologjike. Mësimi online kërkon qasje të reja dhe rivlerësim të të gjithë procesit mësimor për të gjetur rrugë dhe mundësi që mësimi të jetë atraktiv në mungesë të komunikimit njerëzor, por gjithsesi nuk mund të pajtohem me idenë se mësimi online është perspektiva e së nesërme për procesin mësimor, sepse asnjëherë nuk mendojmë se filmi mund të zëvendësojë librin dhe kurrsesi nuk mendojmë se teatri mund të shijohet njëlloj si nga skena, ashtu edhe duke e dëgjuar në radio.” Arti i komunikimit publik, gjuha e trupit, gjestikulacioni, pesha e fjalës, sugjestionimi dhe ngjallja e empatisë tek auditori janë detaje, të cilat nuk mund të qasen në mënyrë efektive në mësimin online, që gjithsesi është më i ftohtë dhe më i ngurtë, por si përparësi mund të merret edhe kontakti komunikues me nxënësin, gjë që ka vënë në lëvizje dhe interesimin për obligimet dhe detyrat që duhet t’i ketë nxënësi edhe në kushte shtëpie kur është në pyetje ruajtja e shëndetit.” (Guce, 2020)

Si përparësi e mësimit online është përgjegjshmëria dhe kontributi i prindërve që pati qasje në informacionin, suksesin dhe angazhimin e fëmijës, por shtohet rreziku që fëmijët të krijojnë varshmëri nga prindërit në zgjidhjen e detyrave duke mos u bërë vetë hulumtues. Vërtet është folur

për mësim online, lidhja e nxënësve me shkollën përmes teknologjisë, por nuk duhet të harrojmë faktin, që jo të gjithë fëmijët e kanë pasur këtë mundësi. Këtë mundësi mund ta kenë ata fëmijë, që janë në qendër të qytetit të Lipjanit, por ka fëmijë të tjerë, që janë në zona rurale, në zona të thella rurale, por nuk kishin mundësi ekonomike për të blerë internet, për të paguar internetin. Kështu që vërtet mendojmë që fëmijët duhet të jenë të përfshirë, që të mos harrojnë, mos të largohen nga librat, të jenë pranë librave, sepse një periudhë e gjatë larg tyre, sigurisht ftoh dhe marrëdhënien e tyre me shkollën, me librat etj. Pra e bën më të vështirë rikthimin. Në njërin anë mësimi online njihet si mundësi e mirë sepse secili mund të mësojë me tempon e tij, pra duke mos u përshtatur me të tjerët, por në anën tjetër jo të gjithë kanë qasje në mundësitë e njëjta dhe jo të gjithë e kanë situatën në familje të qëndrueshme. Për shembull e kemi pa fatkeqësisht që me pandeminë janë rritur edhe rastet e dhunës në familje në Lipjan.

KAPITULLI III

3.1. Metodologjia e punimit

3.2. Lënda e hulumtimit

“Të mësuarit online tashmë nuk është risi. Risi mund ta llogaritim përdorimin e teknologjive të reja, ngase të nxënësve online (distance learning) është i vjetër me shekuj. Një përshkrim shkarazi për fillimin e të mësuarit online nëpërmjet teknologjive të reja e detajon fillimin dhe përparimin që patën vendet e rajonit dhe më gjerë. “ (Major, 2015)

“ Të mësuarit online është përcjellje e njohurive të programit mësimor me anë të pajisjeve të TIK-ëve, nëpërmjet internetit. Kjo platformë u ofron kushte plotësisht të barabarta të gjithë vijuesve të saj, pavarësisht se ku gjenden ata.” Pa dyshim, me përdorimin e internetit, të mësuarit online u bë një përditshmëri e lehtë dhe e shpejtë, përderisa lundrimi nëpër internet për të gjetur se ku janë fillet e të mësuarit online na ndihmon ta kemi një pasqyrë më të afërt për kohërat e mundimshme për të nxënë online”. (Soltan, 2015)

Duke ditur se e gjithë bota po përballet me virusin Covid-19, një armik i padukshëm dhe i cili është ende i panjohur për të gjithë, u ndje nevoja që mësimi online të bëhet domosdoshmëri deri në përfundimin e mësimit, respektivisht në përfundimin e vitit shkollor, dhe akademik. Pikërisht për t’u njohur me historikun e mësimit online, përparimin e teknologjisë informative, vështirësitë dhe përparësitë e këtij procesi mësimor, na nxiti që kjo temë të jetë si objekt studimi dhe hulumtimi i këtij punim masteri. Tema **“Menaxhimi i mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësimitdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit”** do të jetë objekt i studimit dhe hulumtimit tonë i cili do të pasqyrojë menaxhimin, përparësitë dhe vështirësitë e mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësimitdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit.

4.3. Qëllimi I hulumtimit

Që nga 12 marsi për shkak të pandemisë, respektivisht për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, mësimi i rregullt në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës u ndërpre dhe me këtë u paraqit nevoja, që ky proces mos të ndalet krejtësisht, por të organizohet dhe të zhvillohet online, respektivisht nga shtëpia. Pikërisht, ky punim ka për qëllim hulumtimin mbi qëndrimet e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve në përdorimin e mësimit online në shkollat fillore, përshtatshmërinë e mësimitdhënies duke shfrytëzuar teknologjinë, si dhe zhvillimin e shkathtësive komunikuese përmes tyre, duke vënë në pah të metat që mund t’u përvidhen mësimitdhënësve nga

anashkalimi i teknikave bashkëkohore e të cilat më pas reflektojnë te nxënësit të nxënës në mësim etj. Pra, qëllimi i këtij punimi masteri është hulumtimi në terren, në institucionet arsimore dhe me protagonistët e sistemit arsimor dhe të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, mundësive, përparësive, pengesave dhe sfidave për implementimin e të nxënës online në këtë kohë pandemie. Hulumtimi bazohet në çështjet si:

- Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimin online?
- Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?
- Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online?
- Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin online?-

3.4. Hipotezat kryesore të këtij punimi janë;

3.4.1.Hipoteza gjenerale

Menaxhimi i mësimin online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit paraqet një sfidë të madhe për shkollat, nxënësit, arsimtarët, prindërit dhe Ministrinë e Arsimit. Ky proces u imponua si rrjedhim i pandemisë dhe gradualisht u krijua sistemi i komunikimit me tendencë të përmirësimit dhe përfshirjes më të madhe të nxënësve në këtë sistem.

3.4.2.Hipoteza ndihmëse

Supozohet se aplikimi i metodës së të mësuarit online kërkon si parakusht ndryshimin e menaxhimit të sistemit arsimor dhe shkollave në Republikën e Kosovës.

3.4.3.Hipoteza e veçantë

Mësimdhënësit menaxhuan relativisht mirë mësimin online në këtë kohë pandemie. Ky sistem komunikimi ka anët e veta të forta dhe pikat e dobëta të cilët po debatohen me të madhe nga ekspertët, institucionet kompetente, prindërit dhe arsimtarët etj.

3.5. Metodologjia e hulumtimit

3.5.1 Metodat dhe teknikat e hulumtimit

Për të kryer hulumtimin mbi “**Menaxhimi i mësimin online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit**”, janë përdorur këto metoda: **Metoda e analizës teorike**- me anë të kësaj metode përmes e leximeve, shkrimeve e studimeve të ndryshme do të vijmë deri te realizimi dhe analiza e rezultateve të hulumtimit. Nëpërmjet kësaj metode është bërë zbërthimi i mendimeve të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve për pikëpamjet e tyre rreth të mësuarit tradicional (shkollë) dhe atij online, nëpërmjet teknologjive të reja.

Metoda statistikore - përmes kësaj metode të dhënat e grumbulluara do të përpunohen, analizohen dhe interpretohen me anën e përqindjes statistikore përmes programit SPSS (Statistical Package for the Social Sciences).

Metoda deskriptive - pas studimit dhe analizimit do të përshkruhen të dhënat e nxjerra nga hulumtimi.

Metoda e konkretizimit: Hulumtimi ka të bëjë me të mësuarit, i cili konkretizohet në mësim tradicional dhe mësim online. Të mësuarit është kuptim i përgjithshëm që nënkupton mësimin tradicional, ndërsa kur të mësuarit e konkretizojmë ia shtojmë prepozicionet: online nëpërmjet teknologjive të reja, si Email, MSN, Viber, Zoom etj.

3.6. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

Pyetësi në vetvete, konsiderohet i përshtatshëm, pasi konsiderohet i dobishëm në mbledhjen e të dhënave mbi ndjesitë dhe perceptimet e një grupi njerëzish (Peers, 1996). Kështu, pyetësit do të përdoren me drejtorë dhe mësimdhënës, për të kërkuar informacion më shumë rreth “**Menaxhimi i mësimin online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit**”.

Në pyetësorë do të përfshihen edhe pyetjet demografike (gjinia, mosha, shkollimi, profesioni) kurse përpunimi statistikor i këtyre të dhënave do të bëhet me anë të programit SPSS.

Kurse nëpërmjet intervistës do të kemi mundësi për të ndërvepruar drejtpërdrejt me pjesëmarrësit e hulumtimit që do të jenë prindërit e këtyre shkollave. Në studimin tonë, intervista do të jetë gjysmë të strukturuar, duke mundësuar kështu një njohje më të mirë të dukurisë së studiuar, do të përfshijë pyetje sa i përket efektshmërisë së ushtrimit të punës me nxënës dhe menaxhimit të mësimdhënësve të mësimin online gjatë kohës së pandemisë.

Procedurat për mbledhjen e këtyre të dhënave do të jenë të thjeshta, sepse paraprakisht kemi kontaktuar me udhëheqësit e këtyre shkolla dhe kemi marrë mbështetjen e tyre për të realizuar këtë hulumtim në këto shkolla, kurse pjesën tjetër të punës do ta bëjmë me mjete vetanake.

Shpërndarjen e pyetësorëve në shkollat e lartcekura do ta bëjmë në secilën shkollë dhe njëkohësisht do ta bëjmë edhe intervistat me drejtorët edhe mësimdhënësit e shkollave. Këtë hulumtim do ta bëjmë për platformës Zoom, kurse plotësimin e pyetësorëve do ta bëjmë përmes platformave tjera si: Email, Viber, MSN.

3.7.Popullacioni dhe mostra

Popullata e këtij hulumtimi do të përfshijë mësimdhënësit, prindërit dhe drejtorët e Komunës së Lipjanit. Kjo popullatë është numerikisht e caktuar dhe gjithsej, sipas statistikave të DKA-se në Lipjan me rrethinë, janë mbi 1700 mësimdhënës të punësuar. Meqë Komuna e Lipjanit me rrethinë ka afërsisht mbi 1700 mësimdhënës, atëherë për t'u studiuar kemi përzgjedhur kampionin e qëllimshëm. Në Komunën e Lipjanit janë gjithsej të punësuar 15 pedagogë dhe 8 psikologë. Për studim kemi përzgjedhur: SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, “Ismail Luma”, “Emin Duraku”, “Skënderbeu”, “Kadri Beba” “Nezë Buja”, Vëllezërit Domaneku” “Hajredin Bajrami”. Ky kampion do të përfshijë 80 mësimdhënës të shkollave fillore të mesme të ulëta, 8 drejtorë, 80 prindër. Kemi përzgjedhur 80 mësimdhënës të rregullt, sepse mendojmë që ky numër është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për marrjen e informacioneve, pasi kemi zgjedhur 8 shkolla dhe në secilën shkollë do të pyesim drejtorët dhe nga 10 mësimdhënës. Ndërsa, 80 prindër d.m.th nga 10 prindër në çdo shkollë. Kampioni përfshin 15 shkolla gjithsej, tetë shkolla janë të përfshira në Komunën e Lipjanit me rrethinë, të cilat janë përfshirë në pyetësor me mësimdhënës dhe drejtorë, pra: 4 shkolla fillore në qytetin e Lipjanit, kurse 4 shkollat e tjera janë në pjesët rurale, respektivisht në rrethinë të qytetit të Lipjanit.

3.8.Rëndësia e punimit

Ky hulumtim është mjaft i rëndësishëm, sepse rrit vetëdijen e mësimitdhënësve, prindërve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, pedagogëve, psikologëve, dhe institucioneve të tjera për ndryshime, përfshirë këtu edhe sa më shumë mësimin online përmes platformave të ndryshme. Krahas zhvillimit të teknologjisë duhet të rritet edhe ndërgjegjësimi i strukturave relevante të përmendura për ta përdorur teknologjinë informative në të mirë të mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore dhe bashkëkohore.

KAPITULLI I IV

4.1 Analiza dhe interpretimi i rezultateve

4.2 Rezultatet nga pyetësi me mësimdhënës

Të nderuar mësimdhënës, ky pyetësor ka për qëllim të marrë informacion rreth temës: “**Menaxhimi i mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit**”.

Pjesëmarrja juaj në këtë studim nuk është e detyrueshme. Të dhënat e studimit do të jepen të përmbledhura, pa përmendur personin që ka plotësuar pyetësorin. Pra, i gjithë informacioni që do të merret nga ky studim, do të trajtohet si informacion koinfidencial dhe do të jetë vetëm në dispozicion të studiuesit, që do të përpunojë të dhënat e këtij studimi. Ju lutem përgjigjuni me vërtetësi në çdo pyetje, në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë, të paraqesin gjendjen reale me të gjitha arritjet dhe vështirësitë.

Paraprakisht ju falënderojmë për kontributin në këtë studim. Shënoni me X shkronjën përbri përgjigjes që reflekton më mirë opinionin tuaj ose rrethojeni atë. Në rast se ka një vizë (p.sh. _____), ju lutem shkruani informacionin e kërkuar mbi të, në mënyrë të lexueshme.

Emri i shkollës: _____ Vendi : _____

Ju faleminderit për mirëkuptim!

I. Të dhënat personale për mësimdhënës

Cila është gjinia, mosha dhe përgatitja profesionale e mësimdhënësve?

Tab. Nr.1. - Statistics (Statistikat përmbledhëse)


	Gjinia						
	Mashkullore / femërore	Meshkuj / Femra 21- 40 vjeç	Meshkuj / femra 41 - 55 veç	Meshkuj / femra mbi 55 veç	Master	Fakulteti i edukimit (Bachelor)	Fakulteti pedagogjik
N Valid	80	35	31	10	6	70	2
Mean	1,79	1,83	1,84	1,70	1,83	1,81	1,50
Mode	2	2	2	2	2	2	1 ^a
Std. Deviation	,412	,382	,374	,483	,408	,392	,707

Në tabelë janë paraqitur gjinia, mosha dhe përgatitja profesionale e mësimdhënësve.

Tab. Nr.2. Gjinia: meshkuj – femra.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	17	21	21	21
2	63	79	79	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.1.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësime të të dy gjinive, prej tyre 17 apo 21 % janë meshkuj, ndërsa 63 apo 79 % prej tyre janë femra.

Tab. Nr.3. Moshë: 21- 40 vjeç (meshkuj – femra).

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	6	7,5	17,1	17,1
2	29	36,3	82,9	100,0
Total	35	43,8	100,0	

Grafiku nr.2.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 35 mësimdhënës të moshës 21- 40 vjeç, prej tyre 6 apo 17 % janë meshkuj dhe 29 apo 83 % janë femra.

Tab. Nr.4. Moshë e mësimdhënësve: meshkuj - femra (41 – 55 vjeç).

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	5	6,3	16,1	16,1
2	26	32,5	83,9	100,0
Total	31	38,8	100,0	

Grafiku nr.3.

Meshkuj - femra 41 - 55 vjeç




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 31 mësimdhënës të moshës 41- 55 vjeç, prej tyre 5 apo 16 % janë meshkuj dhe 26 apo 84 % janë femra.

Tab. Nr.5. Moshë: mbi 55 vjeç (meshkuj- femra).

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	3,8	30,0	30,0
2	7	8,8	70,0	100,0
Total	10	12,5	100,0	

Grafiku nr.4.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 10 mësimdhënës të moshës mbi 55 vjeç, prej tyre 3 apo 30 % janë meshkuj dhe 7 apo 70 % janë femra.

Tab. Nr.6. Niveli arsimor: Master.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	1,3	16,7	16,7
2	5	6,3	83,3	100,0
Total	6	7,5	100,0	

Grafiku nr.5.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 6 mësime të cilët kanë të kryer masterin, prej tyre 1 apo 17 % janë meshkuj dhe 5 apo 83 % janë femra.

Tab.Nr.7. Niveli arsimor: Fakulteti i Edukimit (Bachelor).

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	26	35,1	43,3	43,3
2	34	45,9	56,7	100,0
Total	60	81,1	100,0	

Grafiku nr.6.

Fakulteti i edukimit (bachelor)




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 60 mësimdhënës të cilët kanë të kryer Fakultetin e Edukimit (Bachelor), prej tyre 13 apo 19 % janë meshkuj dhe 57 apo 81 % janë femra.

Tab. Nr.8. Niveli arsimor – Fakulteti i Pedagogjisë.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	1,3	50,0	50,0
2	1	1,3	50,0	100,0
Total	2	2,5	100,0	

Grafiku nr.7.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 2 mësimdhënës të cilët kanë të kryer Fakultetin Pedagogjik, prej tyre 1 apo 50 % janë meshkuj dhe 1 apo 50 % janë femra.

Tabela nr.9. Statistika deskriptive (Përshkruese).

Petësori me mësimdhënës	N	Mean	Mode	Max	Min	Devijimi standard
1. Si e njihni nocionin mësim online ?	80	1,96	1	1	5	1,227
2. Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?	80	1,82	2	1	3	,677
3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të paisjeve teknologjike?	80	1,78	1	1	3	,900
4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?	80	1,56	2	1	3	,570
5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?	80	1,66	1	1	3	,856
6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?	80	2,06	1	1	5	1,256
8. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?	80	2.63	3	1	3	,984
9. Eksperiencat e juaja për përparësitë e mësimin online?	80	2,63	3	1	3	,984
10. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online	80	1,79	2	1	3	,706
Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimin online?	80	2.48	2	1	5	,968
11. Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin online?	80	2.63	3	1	3	,984
12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nëse po, në cilat aspekte?.	80	2.60	1	1	3	,863
13. . Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?	80	2.52	2	2	3	,987
14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmer lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?	80	2.48	1	3	3	,856

Në këtë tabelë janë të paraqitura të dhënat për 9 pyetjet për 80 mësimdhënës që kanë qenë pjesëmarrës në këtë hulumtim. Në këtë tabelë është paraqitur mesatarja, modi, minimumi, maksimumi dhe devijimi standard për secilën pyetje në tabelë.

Tab.nr.10. 1. Si e njihni nocionin mësim online ?

Tab. Nr.11	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	27	33,8	33,8	33,8
2	41	51,3	51,3	85,0
3	12	15,0	15,0	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.8.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 27 apo 34 % janë përgjigjur se nocionin mësim online e njohin si mësim nga largësia, 41 apo 51 % prej tyre, janë përgjigjur se është mësim nga televizioni, 12 apo 15 % prej tyre, janë përgjigjur se nuk e dinë saktësisht etj.

Tab.nr.11. 2. Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?

Tab. Nr.11	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	27	33,8	33,8	33,8
2	41	51,3	51,3	85,0
3	12	15,0	15,0	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.9.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 27 apo 34 % janë përgjigjur se mesatarisht dinë të përdornin internetin, apo mjetet e tjera teknologjike, 41 apo 51 % prej tyre, janë përgjigjur se mjaft mirë e njohin internetin dhe mjetet e tjera teknologjike, 12 apo 15 % prej tyre, janë përgjigjur se fare pak.

Tab.nr.12. 3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike?

Tab.nr.12	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	43	53,8	53,8	53,8
2	12	15,0	15,0	68,8
3	25	31,3	31,3	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.10.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 25 apo 31.3 % janë përgjigjur se mesatarisht nxënësit e njohin dhe kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike, 43 apo 53.8 % prej tyre, janë përgjigjur se mjaft mirë nxënësit e njohin dhe kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike, 12 apo 15 % prej tyre, janë përgjigjur se fare pak.

Tab.nr.13. 4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?

Tab.nr.13	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	38	47,5	47,5	47,5
2	39	48,8	48,8	96,3
3	3	3,8	3,8	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.11.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 38 apo 47.5 % janë përgjigjur se mesatarisht kanë ndjekur ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut, 41 apo 51 % prej tyre janë përgjigjur se kanë ndjekur trajnime që kanë të bëjnë me TIK-un, 3 apo 3.8 % prej tyre, janë përgjigjur se fare pak.

Tab.nr.14. 5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?

Tab. Nr.14	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	47	58,8	58,8	58,8
2	13	16,3	16,3	75,0
3	20	25,0	25,0	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.12.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 47 apo 59 % janë përgjigjur se nuk pajtohen se ishin të përgatitur për ta ndjekur mësimi online, 13 apo 16 % prej tyre janë përgjigjur se pajtohen pjesërisht dhe 20 apo 25 % pajtohen se ishin të përgatitur për ndjekur mësimin online bashkë me nxënësit e tyre.

Tab.nr.15. 6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?

Tab. Nr.15	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	37	46,3	46,3	46,3
2	18	22,5	22,5	68,8
3	14	17,5	17,5	86,3
4	5	6,3	6,3	92,5
5	6	7,5	7,5	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.13.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 37 apo 46 % janë përgjigjur se fare nuk pajtohen se ishin të përgatitur, 18 apo 23 % prej tyre janë përgjigjur se për ata që njohin teknologjinë informative nuk ka qenë problematike, 14 apo 18 % prej tyre janë përgjigjur se plotësisht pajtohen se ishin të përgatitur, 5 apo 6 % prej tyre janë përgjigjur se pajtohen dhe 6 apo 8 % prej tyre janë përgjigjur se mesatarisht pajtohem se ishin të përgatitur për t'ju ndihmuar fëmijëve të tyre që të ndjekin mësimin online.

Tab.nr.16. 7. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?

Tab. Nr.16	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	12	15,0	15,0	15,0
2	19	23,8	23,8	38,8
3	38	47,5	47,5	86,3
4	8	10,0	10,0	96,3
5	3	3,8	3,8	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.14.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 12 apo 15% janë përgjigjur se njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online ishin mungesa e internetit, 19 apo 24 % , janë përgjigjur se ishte pengesë rryma, 38 apo 48 % prej tyre janë përgjigjur se mungesa e aftësive të përdorimit të platformave digjitale, 8 apo 10 % prej tyre nuk njihja asnjë platformë digjitale dhe 3 apo 4 % prej tyre janë përgjigjur se mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara

Tab.nr.17. 8. Eksperiencat e juaja për përparësitë e mësimit online?

Tab. Nr.18	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	10	12,5	12,5	12,5
2	38	47,5	47,5	60,0
3	17	21,3	21,3	81,3
4	14	17,5	17,5	98,8
5	1	1,3	1,3	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.15



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësime, prej tyre 10 apo 13% janë përgjigjur se si përparësi e mësimit online ishte krijon lidhje të reja mësime- nxënës, 38 apo 48 % prej tyre janë përgjigjur se penguan dështimin e vitit shkollor, 17 apo 21 % prej tyre janë përgjigjur se si eksperience ishte se krijon qasje të reja për mësime dhe mësime, 14 apo 18 % prej tyre janë përgjigjur se ishte mjaft e vështirë për t'u përballur dhe 1 apo 1 % prej tyre është përgjigjur se e ardhmja parasheh edhe këtë lloj mësime.

Tab.18. 9. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online?

Tab. Nr.17	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	30	37,5	37,5	37,5
2	37	46,3	46,3	83,8
3	13	16,3	16,3	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.16.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 30 apo 38 % janë përgjigjur se pajisjet teknologjike që kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online ishin telefoni, 37 apo 46 % prej tyre janë përgjigjur kishin në dispozicion llaptopi, 13 apo 16 % prej tyre janë përgjigjur, vetëm përmes TV-së së RTK-së

Tab.nr.19. 10.Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimit online?

Tab. Nr.16	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	12	15,0	15,0	15,0
2	19	23,8	23,8	38,8
3	38	47,5	47,5	86,3
4	8	10,0	10,0	96,3
5	3	3,8	3,8	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.17.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 12 apo 15% janë përgjigjur se nxënësit arrijnë t'i kuptojnë mësimet online 19 apo 24 % prej tyre janë përgjigjur, se nxënësit nuk arrijnë të kuptojnë mësimin, pasi kam vështirësi të ndjek shpjegimin online online., 38 apo 48 % prej tyre janë përgjigjur se janë kënaqur me kohën e dhënë për të kryer detyrat e tyre, 8 apo 10 % prej tyre janë përgjigjur se janë të kënaqur me llojin e detyrave që u jepen, dhe 3 apo 4 % prej tyre janë përgjigjur se nxënësit janë të kënaqur me mënyrën e vlerësimit që po përdorin mësuesit.

Tab.nr.20. 11. Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimit online?

Tab. Nr.17	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	30	37,5	37,5	37,5
2	37	46,3	46,3	83,8
3	13	16,3	16,3	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.18.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësime, prej tyre 30 apo 38 % janë përgjigjur se platformat teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimit online janë: MSN, Viber, 37 apo 46 % prej tyre janë përgjigjur se platforma Zoom dhe Skype janë më të përshtatshme, 13 apo 16 % prej tyre janë përgjigjur Google Classroom..

Tab.nr.21. 12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nëse po, në cilat aspekte?

Tab. Nr.17	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	30	37,5	37,5	37,5
2	37	46,3	46,3	83,8
3	13	16,3	16,3	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.19.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, prej tyre 30 apo 38 % janë përgjigjur se mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve aspektin e monitorimit të pjesëmarrjes së nxënësve, 37 apo 46 % prej tyre janë përgjigjur se mungesa e pajisjeve teknologjike te nxënësit, 13 apo 16 % prej tyre janë përgjigjur vështirësi në vlerësimin e nxënësve.

Tab.nr.22. 13. Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?

Tab.nr.13	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	38	47,5	47,5	47,5
2	39	48,8	48,8	96,3
3	3	3,8	3,8	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr.20.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, në pyetjet se çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, prej tyre 38 apo 48 %, u përgjigjën të gjitha si mjetet ashtu edhe mjetet, 39 apo 49 % prej tyre, janë përgjigjur se shkollat tona nuk ofrojnë mundësi digjitalizimi dhe 3 apo 4 % prej tyre, janë përgjigjur se kuadri profesional.

Tab.nr.23. 14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?

Tab.nr.13	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	38	47,5	47,5	47,5
2	39	48,8	48,8	96,3
3	3	3,8	3,8	100,0
Total	80	100,0	100,0	

Grafiku nr21.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 mësimdhënës, në pyetjen se cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen, 38 apo 48 janë përgjigjur se asnje hap konkretë, 39 apo 49 % prej tyre, janë përgjigjur se do të trajnojnë mësimdhënësit dhe 3 apo 4 % prej tyre, janë përgjigjur se pritët që MASHT- ta zgjidh këtë problem.

4.4 Rezultatet nga pyetësi me drejtorët e shkollave

Të nderuar drejtorë ky pyetësor ka për qëllim të marrë informacion rreth temës: “ **Menaxhimi i mësimit online gjatë kohës së pandemisë nga mësimmshënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Lipjanit**”.

Pjesëmarrja juaj në këtë studim nuk është e detyrueshme. Të dhënat e studimit do të jepen të përmbledhura, pa përmendur personin që ka plotësuar pyetësin. Po kështu, i gjithë informacioni që do të merret nga ky studim do të trajtohet si informacion koinfidencial dhe do të jetë vetëm në dispozicion të studiuesit që do të përpunojë të dhënat e këtij studimi. Ju lutem përgjigjuni me vërtetësi në çdo pyetje, në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë të paraqesin gjendjen reale, me të gjitha arritjet dhe vështirësitë.

Paraprakisht ju falënderojmë për kontributin në këtë studim. Shënoni me X shkronjën përbri përgjigjes që reflekton më mirë opinionin tuaj ose rrethojeni atë. Në rast se ka një vizë (p.sh. _____) ju lutem shkruani informacionin e kërkuar mbi të në mënyrë të lexueshme.

Emri i shkollës: _____ . Vendi : _____ .

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Të dhënat personale për drejtorë

Cila është gjinia, mosha, përgatitja e mësimmshënësve dhe vendbanimi?


Tab. Nr.24.- Statistics (Statistikat – mosha dhe niveli arsimor i drejtorëve të shkollave).

	Mosha 21 - 40 vjeç	Mosha 41- 55 vjeç	Mbi 55 vjeç	Master	F. edukimi Bachelor	Fakultet tjetër
N Valid	3	4	1	3	3	2
Mean	1,67	1,40	1,0000	1,6667	1,2000	1,5000
Mode	2	1	1,00	2,00	1,00	1,00 ^a
Std. Deviation	,577	,548		,57735	,44721	,70711

Tab.nr.25. Drejtorët –Moshë: 21- 40 vjeç.

Tab. Nr.20	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	33,3	33,3
2	2	25,0	66,7	100,0
Total	3	37,5	100,0	

Grafiku nr.22




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 3 drejtorë të moshës 21- 40 vjeç, prej tyre 1 apo 33 % janë meshkuj dhe 2 apo 67 % janë femra.

Tab.26. Drejtorët –Moshë: 41 – 55 vjeç.

Tab. Nr.21	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	75,0	75,0	75,0
2	1	25,0	25,0	100,0
Total	4	100,0	100,0	

Grafiku nr.23.

Drejtorët - Moshë - 41 - 55 vjeç




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 4 drejtorë të moshës 41- 55 vjeç, prej tyre 3 apo 75 % janë meshkuj dhe 1 apo 25 % janë femra.

Tab.27. Drejtorët mbi 55 vjeç.

Tab. Nr.22	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	100,0	100,0

Grafiku nr.24.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga 8 drejtor, 1 drejtor i moshës mbi 55 vjeç është i gjinisë mashkullore.

Tab.nr. 28. MASTER

Tab. Nr.23	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1,00	1	12,5	33,3	33,3
2,00	2	25,0	66,7	100,0
Total	3	37,5	100,0	

Grafiku nr.25.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 3 drejtorë të cilët e kanë të kryer masterin, prej tyre 1 apo 33 % është i gjinisë mashkullore dhe 2 apo 67 % janë të gjinisë femërore.

Tab.nr.28. BACHELOR

Tab. Nr.24	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1,00	3	75,0	75,0	75,0
2,00	1	25,0	25,0	100,0
Total	4	100,0	100,0	

Grafiku nr.26.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 4 drejtorë të cilët e kanë të kryer fakultetin (Bachelor), prej tyre 3 apo 75 % janë të gjinisë mashkullore dhe 1 apo 25 % janë të gjinisë femërore.

Tab.nr.29. Fakultet tjetër

Tab. Nr.25	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	100,0	100,0

Grafiku nr. 27.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 1 drejtor i gjinisë mashkullore i cili ka të kryer fakultet tjetër (nuk ka cekur se cilin fakultet) .

Tabela nr.30. Statistika deskriptive (Përshkruese).

Pyetësi me drejtorë	N	Mean	Mode	Max	Min	Devijimi standard
1. Si e njihni nocionin mësim online ?	80	1,96	1	1	5	1,227
2. Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?	80	1,82	2	1	3	,677
3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të paisjeve teknologjike?	80	1,78	1	1	3	,900
4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?	80	1,56	2	1	3	,570
5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?	80	1,66	1	1	3	,856
6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?	80	2,06	1	1	5	1,254
8. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në mësimin online?	80	2.63	3	1	3	,984
9. Eksperiencat e juaja për përparësitë e mësimin online?	80	2,63	3	1	3	,984
10. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online	80	1,79	2	1	3	,706
Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimin online?	80	2.48	2	1	5	,968
11. Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimin online?	80	2.63	3	1	3	,984
12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe nëse po, në cilat aspekte?.	80	2.60	2	2	3	,876
13. . Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?	80	1.86	2	2	2	,987
14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmer lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?	80	1	1	2	2	,758

Në këtë tabelë janë të paraqitura të dhënat për 14 pyetjet për 8 drejtorë që kanë qenë pjesëmarrës në këtë hulumtim. Në këtë tabelë është paraqitur mesatarja, modi, minimumi, maksimumi dhe devijimi standard për secilën pyetje në tabelë.

Tab.nr.31 **1.Si e njihni nocionin mësım online?**

Tab. Nr.29	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	37,5	37,5	37,5
2	4	50,0	50,0	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.28.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik, shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 3 apo 38 % janë përgjigjur se nocionin mësım online e njohin si mësim nga largësia, 4 apo 50 % prej tyre janë përgjigjur se mësim nga kanalet televizive, 1 apo 13 % prej tyre janë përgjigjur se përmes mësimit online nuk mund të jesh drejtpërdrejt me nxënësin.

Tab.nr.32 2.Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?

Tab. Nr.27	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	5	62,5	62,5	62,5
2	3	37,5	37,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr. 29.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 5 apo 63 % janë përgjigjur se dinë të përdorin internetin dhe mjetet e tjera teknologjike dhe 3 apo 38% prej tyre janë përgjigjur mesatarisht dinë të përdorin internetin dhe mjetet e tjera teknologjike.

Tab.33. 3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike

Tab. Nr.29	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	3	37,5	37,5	37,5
2	4	50,0	50,0	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.30.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 3 apo 37.5 % janë përgjigjur se mesatarisht, nxënësit e njohin dhe kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike, 4 apo 50.0 % prej tyre, janë përgjigjur se mjaft mirë, nxënësit e njohin dhe kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike, 1 apo 12.5 % prej tyre, janë përgjigjur se fare pak.

Tab.nr.34. 4. Keni ndjekur sigurisht ndonjë kurs apo trajnim të përvetësimit të TIK-ut?

Tab. Nr.27	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	5	62,5	62,5	62,5
2	3	37,5	37,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr. 32.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 5 apo 63 % janë përgjigjur se kanë ndjekur trajnime dhe 3 apo 38% prej tyre janë përgjigjur se e kanë mësuar vet nga dëshira.

Tab.nr.35 5. Për shkak të pandemisë u detyruat të punoni online, sa ishit të përgatitur ju dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?

Tab.nr.31	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	6	75,0	75,0	75,0
2	1	12,5	12,5	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr. 33.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 6 apo 75% janë përgjigjur se mesatarisht ishin të përgatitur për ta ndjekur mësimin online për shkak të pandemisë, 1 apo 13% prej tyre janë përgjigjur se pajtohem pjesërisht dhe prej 8 drejtorëve, 1 apo 13% e tyre janë përgjigjur se pajtohen se ishin të përgatitur për ta ndjekur mësimin online për shkak të pandemisë.

Tab.35. 6. Sa ishin të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?

Tab.nr.32	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	12,5	12,5
2	5	62,5	62,5	75,0
3	2	25,0	25,0	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.34.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 5 apo 62.5 % janë përgjigjur se fare nuk ishin të përgatitur, 2 apo 25 % prej tyre janë përgjigjur se ishin mesatarisht të përgatitur, 1 apo 12.5 % prej tyre janë përgjigjur se plotësisht pajtohen se ishin të përgatitur se ishin të përgatitur për t'ju ndihmuar fëmijëve të tyre që të ndjekin mësimin online.

Tab.nr.37 7. Cilat ishin njohuritë dhe vështirësitë e mësimeve në përdorimin e teknologjisë në mësime online?

Tab. Nr.35	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	2	25,0	25,0	25,0
2	4	50,0	50,0	75,0
3	1	12,5	12,5	87,5
4	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.35.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 4 apo 50% janë përgjegjës për njohuritë dhe vështirësitë e mësimeve në përdorimin e teknologjisë në mësime online ishin mungesa e internetit, 2 apo 25 %, janë përgjegjës për pengesë rryma, 1 apo 12.5 % prej tyre është përgjegjës për mungesa e aftësisë së përdorimit të platformave digjitale , 1 apo 12.5 % prej tyre nuk njihnin asnjë platformë digjitale.

Tab.nr.39. 9. Eksperiencat e juaja për përparësitë e mësimit online?

Tab.nr.32	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	12,5	12,5
2	5	62,5	62,5	75,0
3	2	25,0	25,0	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.36




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 5 apo 62.5% janë përgjigjur se si përparësi se penguan dështimin e vitit shkollor, 2 apo 25 % prej tyre janë përgjigjur se ishte mjaft e vështirë për t'u përballur dhe 1 apo 12.5 % prej tyre është përgjigjur se e ardhmja parasheh edhe këtë lloj mësimi.

Tab.nr.39. 9. Cilat pajisje teknologjike i kishin në dispozicion mësime dhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online

Tab. Nr.30	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	5	62,5	62,5	62,5
2	2	25,0	25,0	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.37.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 5 apo 62.5 % janë përgjigjur se pajisjet teknologjike që kishin në dispozicion mësime dhënësit dhe nxënësit për të zhvilluar mësimin online ishin telefoni, 2 apo 25 % prej tyre janë përgjigjur se kishin në dispozicion llaptopin, 1 apo 12.5 % prej tyre janë përgjigjur, vetëm përmes TV-të RTK-së

Tab.nr.40. 10.Sa nxënësit i vlerësojnë njohuritë e tyre në përdorimin e mësimit online?

Tab.nr.32	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	1	12,5	12,5	12,5
2	5	62,5	62,5	75,0
3	2	25,0	25,0	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.38.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 2 apo 12.5% janë përgjigjur se nxënësit arrijnë t'i kuptojnë mësimit online 5 apo 62.5 % prej tyre janë përgjigjur, se nxënësit nuk arrijnë të kuptojnë mësimit, pasi kam vështirësi të ndjek shpjegimin online ., 1 apo 12.5 % prej tyre janë përgjigjur se janë të kënaqur me punën e mësimeve.

Tab.nr.41. 11. Cilat platforma teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimimit online?

Tab.nr.31	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	6	75,0	75,0	75,0
2	1	12,5	12,5	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr. 39.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 80 drejtorë, prej tyre 6 apo 75 % janë përgjigjur se platformat teknologjike ishin më të përshtatshme për zhvillimin e mësimimit online janë: MSN, Viber, 1 apo 12.5 % prej tyre është përgjigjur se platforma Zoom dhe Skype janë më të përshtatshme , 1 apo 12.5 % prej tyre është përgjigjur Google Classroom..

Tab.nr. 42. 12. Mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimeve dhe nëse po, në cilat aspekte?.

Tab. Nr.30	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	5	62,5	62,5	62,5
2	2	25,0	25,0	87,5
3	1	12,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.40.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, prej tyre 2 apo 25 % janë përgjigjur se mësimi elektronik e vështirësoi punën e nxënësve dhe të mësimeve dhe aspektin e monitorimit të pjesëmarrjes së nxënësve, 5 apo 62.5 % prej tyre janë përgjigjur se mungesa e pajisjeve teknologjike të nxënësve, 1 apo 12.5 % prej tyre është përgjigjur vështirësi në vlerësimin e nxënësve.

Tab.nr. 43. 13. Çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, kuadri profesional apo mjetet?

Tab.nr.31	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	4	50,0	50,0	50,0
2	1	12,5	12,5	50,0
3	3	37,5	12,5	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr. 41.




Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, në pyetjet se çka i mungoi shkollës suaj për të realizuar mësimin online, 4 apo 50% të gjitha i munguan, si kuadri profesional ashtu edhe mjetet e tjera, 1 apo 12.5 % prej tyre, është përgjigjur se shkollat tona nuk ofrojnë mundësi digjitalizimi dhe 3 apo 37.5 % prej tyre, janë përgjigjur se kuadri profesional.

Tab.nr.44. 14. Cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen?

Tab. Nr.30	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1	2	25	25	25
2	4	50	50	50
3	2	25	50	100,0
Total	8	100,0	100,0	

Grafiku nr.42.



Nga rezultatet e paraqitura në grafik shihet se nga gjithsej 8 drejtorë, në pyetjen se cilat janë hapat konkretë që shkolla juaj po i ndërmerr lidhur me krijimin e platformës për mësimin elektronik në të ardhmen, 2 apo 25% janë përgjigjur se asnjë hap konkretë, 4 apo 50 % prej tyre, janë përgjigjur se do të trajnojnë mesimdhënësit dhe 2 apo 25 % prej tyre, janë përgjigjur se pritet që MASHT- ta zgjidh këtë problem..

4.5 Rezultatet e përgjithshme të intervistës me prindër

1.Si e njihni nocionin mësim online ?

P. Shumica e prindërve mendojnë se ky lloj mësimi zhvillohet nga largësia,

P. e tjerë .duke parë përvojën tash në kohën e pandemisë, mësim ky që u ndoq nga transmetimi i RTK-së

2.Dini ta përdorni internetin, apo mjetet e tjera teknologjike?

P. Unë si prind nuk di t'i përdor këto të reja, mirëpo telefonin mesatarisht, jo të gjitha, por çka janë të nevojshme.

P. e tjerë. Jo nuk dimë, përveç përdorimit të telefonit.

3.Sa mendoni se nxënësit kanë qasje në internet apo njohje të pajisjeve teknologjike?

P.1,2,3,4 Fëmijët tanë kalojnë shumë kohë qoftë në telefon apo edhe në kompjuter, po besoj se ata janë të rinj dhe i përvetësojnë gjërat.

P.5,6,7 Po fëmijët e mi e njohin mirë sepse ndjekin kurse kompjuteri.

P.8.9.10. Meqë nxënësit janë avancuar në teknologji, mendoj se në një shkallë janë të përgatitur për këtë mënyrë të të nxënës.

. 4.Për shkak të pandemisë mësimdhënësit ishin të detyruar të punonin online,, sa ishit të përgatitur ata dhe nxënësit për ta ndjekur këtë lloj mësimi ?

P.1,2,3 Në bazë të rrethanave, konkludoj se nxënësit me dëshirë do të mësonin online, meqë ata edhe ashtu kohën më të gjatë e kalojnë pranë kompjuterit të konektuar në internet. Së paku do të kishin dobi me këtë platformë.

P.4,5,6 .Por kjo metodë me thënë të drejtën nuk më pëlqen shumë, pasi fëmijëve të mi ju mungon përqendrimi. Aty shpeshherë as nuk bëjmë mësimin tërësisht se fillojnë zërat, flasin me njëra tjetrën dhe ikën ora e mësimin. Për sa i përket provimeve na kanë thënë mësueset që do ta bëjmë online, me një test që ato do të na i nisin dhe ku ne do ta plotësojmë, njësoj siç po funksionon aktualisht me detyrat, por se kuptoj çka vlerë ka e gjitha kjo, kur mësuesja s'është e përgatitur fare për këtë lloj mësimi sepse është e vjetër.

P.7 “Mua në fakt megjithëse jam e re në moshë nuk më pëlqen shumë teknologjia sepse jam me atë idenë që mësimi përthithet më mirë nga afër. Megjithatë ne si mësues po bëjmë maksimumin në këtë situatë që nxënësit të mos mbeten mbrapa. Unë personalisht jap lëndën e anglishtes dhe më thënë të

drejtën shpenzoj thuajse të gjithë ditën me ta sepse ka fjalë e fraza që nxënësit nuk i kuptojnë”, nënë-mësuese, e cila punon mësuese anglishte në një nga gjimnazet e qytetit.

Për sa i përket gjithëpërfshirjes së nxënësve në procesin e të mësuarit online, mësuesja e tregon se nxënësit punojnë në shumicën e rasteve me telefonat e prindërve.

P.8.9 . Ai thotë se mësimi online është sa për të kaluar radhën, aspak cilësor dhe madje diskriminues, pasi nuk i ofrohet të gjithëve.

P.10. Ajo thekson se kjo situatë i kapi të papërgatitur institucionet arsimore. “Teknologjia është shumë e mirë dhe është shumë interesante për t’u aplikuar vetëm se jemi kapur në një lloj befasie për ta menaxhuar dhe aplikuar. Personalisht e shikoj që situata i kapi të papërgatitur institucionet e arsimit. Dhënia e mësimit përmes televizionit për mua do ishte një alternativë shumë më e mirë tani për tani.

6. Sa ishit të angazhuar ju si prindër, për t’i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim online?

P.1,2.Të përgatitur nuk ishim fare por, koha na i imponoi edhe këtë. Nga 9 e mëngjesit deri 9 të mbrëmjes jam ulur dhe akoma si kanë mbaruar detyrat. Po japin nga dy mësimet në ditë. Nuk e kuptoj pse i ngarkojnë kaq shumë. Nuk e di si do shkojë ky muhabet. Jam shumë e shqetësuar për shkollën e fëmijëve, përveç hallit që na zuri me koronavirusin”.

